



FLETORJA ZYRTARE

E REPUBLIKËS SË

SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 127

Tiranë – E martë, 29 gusht 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 494, datë 24.8.2023	Për miratimin e uniformës, shenjave dalluese dhe modelit të dokumentit individual të identifikimit, ngjyrës, shenjave dhe përdorimit të mjeteve lëvizëse të Policisë Bashkiake..... 15119
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 495, datë 24.8.2023	Për disa ndryshime në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian, për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, të ndryshuar..... 15127
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 496, datë 24.8.2023	Për një ndryshim në vendimin nr. 111, datë 1.3.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e buxhetit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, për vitin 2023”..... 15135
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 497, datë 24.8.2023	Për miratimin e marrëveshjes ndryshuese nr. 2, të marrëveshjes së grantit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Suedisë, në lidhje me planifikimin e sektorit të ujit për negociatat me Bashkimin Evropian, të miratuar me vendimin nr. 93, datë 5.2.2020, të Këshillit të Ministrave..... 15137
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 498, datë 24.8.2023	Për miratimin e dëmshpërblimit financiar për disa ish-të dënuar politikë të regjimit komunist..... 15141
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 499, datë 24.8.2023	Për një ndryshim në vendimin nr. 23, datë 18.1.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor, për vitin 2023”, të ndryshuar..... 15142
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 500, datë 24.8.2023	Për përjashtimin nga ndalimi i gjuetisë, për qëllime shkencore pasvaksinale, të kafshëve të vaksinuara, në kuadër të projektit IPA 2020, kontrollin dhe çrrënjosjen e sëmundjes së tërbimit – faza IV... 15143

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 501, datë 24.8.2023	Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Kulturës të pronës me emërtimin “Kalaja e Lëkurësit”, me numër pasurie 26/144, 26/139, 26/487, zona kadastrale 8642, Sarandë.....	15146
Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 11, datë 24.7.2023	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 10, datë 26.1.2015, “Për rregullat dhe procedurat e shqyrtimit të ankimeve administrative të subjekteve minerare të licencuara”.....	15148
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 12983, datë 22.8.2023	Mbi hyrjen në fuqi të marrëveshjes ndërkombëtare.....	15148
Vendim i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit nr. 11, datë 22.8.2023	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH.....	15148
Vendim i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit nr. 12, datë 22.8.2023	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH.....	15156
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 228, datë 17.7.2023	Mbi përcaktimin e shoqërisë “Bursa shqiptare e energjisë elektrike ALPEX” sh.a si operatori i emëruar i tregut të energjisë elektrike (NEMO).....	15157
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 240, datë 3.8.2023	Mbi pezullimin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Teodori 2003” sh.p.k., për transferimin e pjesshëm të licencës për prodhimin e energjisë elektrike, për HEC Zalli i Bulqizës, te shoqëria “Koncesionare Tërnovë Zall Bulqizë” sh.p.k.	15158
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 241, datë 3.8.2023	Mbi kërkesën e shoqërisë “Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 mw.....	15160
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 242, datë 3.8.2023	Mbi licencimin e shoqërisë “Nova Solar System” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 50 mw.....	15162
Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë nr. 12-2023-150 (30), datë 2.2.2023	Për shpalljen të vdekur të shtetasit Naxhi Çaça.....	15163

VENDIM

Nr. 494, datë 24.8.2023

**PËR MIRATIMIN E UNIFORMËS,
SHENJAVE DALLUESE DHE MODELIT
TË DOKUMENTIT INDIVIDUAL TË
IDENTIFIKIMIT, NGJYRËS, SHENJAVE
DHE PËRDORIMIT TË MJETEVE
LËVIZËSE TË POLICISË BASHKIAKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 46, pika 6, dhe 47, pika 2, të ligjit nr. 89/2022, “Për Policinë Bashkiake”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e uniformës dhe të shenjave dalluese të Policisë Bashkiake, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Miratimin e modelit të dokumentit individual të identifikimit të punonjësit të Policisë Bashkiake, sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Miratimin e ngjyrës, shenjave dhe përdorimit të mjeteve lëvizëse të Policisë Bashkiake, sipas lidhjes nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Ngarkohen njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

LIDHJA NR. 1

KREU I

**PARAQITJA, FORMA, SPECIFIKIMET
TEKNIKE DHE PËRSHKRIMI I
UNIFORMËS SË POLICISË BASHKIAKE**

**PARAQITJA DHE FORMA E UNIFORMAVE
TË POLICISË BASHKIAKE**

Uniforma do të jetë e ndarë në 3 lloje:

1. Uniforma shërbimi dimërore;
2. Uniforma shërbimi verore;
3. Uniforma ceremoniale.

1. UNIFORMA SHËRBIMI DIMËRORE

Kostum uniforme (xhaketë, pantallona, këmbishë, kravatë, kapelë, këpucë).



Xhaketa e kostumit të uniformës do të jetë **blu e errët**, me spaleta për vendosjen e shenjave të supit dhe katër kopsa. Ka katër xhepa me kapak (dy xhepa të vegjël në pjesën e gjoksit dhe dy xhepa të mëdhenj të poshtëm). Në krahun e majtë vendoset stema e bashkisë. Te jaka vendoset elementi kryesor i stemës së bashkisë. Xhaketa e uniformës për femra është e njëjtë përveç modelimit, i cili duhet të jetë për femra, me kopsat në anën e majtë.



Pantallonat, njëlloj me xhaketën ngjyrë **blu e errët**. Pantallonat duhet të pajisen me dy xhepa të përparmë diagonal dhe me një xhep të pasmë. Konstruksioni i pantallonave për meshkuj duhet të jetë sipas modelit klasik me vijë hekurosjeje. Pantallonat për femra kanë konstruksion të njëjtë, përveç modelimit, i cili duhet të jetë për femra.



Pamja përpara Pamja prapa

**Këmishë me mëngë të gjata ngjyrë e kaltër.**

Këmisha në pjesën e supave ka 2 spaleta për montimin e shenjave të supit. Mbyllja e këmishës bëhet me 7 kopsa të vogla. Në krahun e majtë vendoset stema e bashkisë. Në krahun e djathtë sipër vendoset shenja e gjoksit. Këmisha për femra është e njëjtë përveç modelimit, i cili duhet të jetë për femra me kopsat në anën e majtë.



Kravata blu e errët, me një shirit të hollë të kaltër dhe gjerësi max. 7–8 cm.



Kapelë blu e errët, me stemën e bashkisë në qendër, shoqëruar me shirit të bardhë përpara dhe me kopsa si të xhakëtës. Ka strehë plastike me ngjyrë të zezë. Ky model do të jetë për punonjësit meshkuj.



Pamja anash



Pamja përpara



Pamja anash

Kapelë blu e errët, me stemën e bashkisë në qendër, shoqëruar me shirit të bardhë përpara. Ky model do të jetë për punonjëset femra.



Pamja anash



Pamja përpara



Pamja anash

Këpucë uniforme ngjyrë e zezë dhe me lidhëse.



Pulovër blu e errët golf me zinxhir. Ka përforcime doku në bërryla dhe supe, me spaleta doku. Në krahun e majtë vendoset stema e bashkisë. Në krahun e djathtë sipër vendoset shenja e gjoksit.



Xhup blu i errët në pjesën poshtë, shoqëruar me shirit të bardhë dhe të kaltër në formë kuadrati. Pjesa e sipërme është ngjyrë e kaltër. Mëngët janë ngjyrë blu e errët së bashku me jakën. Në krahun e majtë vendoset stema e bashkisë dhe në krahun e djathtë, poshtë shiritit shenja e gjoksit. Në pjesën e pasme vendoset mbishkrimi “POLICIA BASHKIAKE”.

Pamja përpara



Pamja prapa

Xhiboks blu i errët në pjesën poshtë, shoqëruar me shirit të bardhë dhe të kaltër në formë kuadrati. Pjesa e sipërme është ngjyrë e kaltër. Mëngët janë një

pjesë ngjyrë blu e errët dhe pjesa tjetër e kaltër. Jaka është blu e errët. Në krahun e majtë vendoset stema e bashkisë dhe në krahun e djathtë, poshtë shiritit shenja e gjoksit. Në pjesën e pasme vendoset mbishkrimi “POLICIA BASHKIAKE”.

Pamja përpara



Pamja prapa

Këpucë me qafa ngjyrë e zezë, me lidhëse. Këto shërbejnë edhe për stërvitje.



Bluzë e brendshme dimri e trikotuar, ngjyrë e zezë, me jakë rrethore. Në pjesën përpara në anën e majtë sipër, vendoset stema e bashkisë dhe në pjesën prapa do të ketë mbishkrimin “POLICIA BASHKIAKE”. Ky model shërben edhe për stërvitje.



Pamja përpara



Pamja prapa

Bluzë me mëngë të gjata ngjyrë blu e errët, e trikotuar, e hapur në mes dhe mbyllet përpara me tri kopsa të vogla. Në krahun e majtë vendoset stema e bashkisë, ndërsa përpara në krahun e djathtë sipër, vendoset shenja e gjoksit. Bluza për femra është e njëjtë përveç modelimit, i cili duhet të jetë për femra me kopsat në anën e majtë.



Pelerina e shiut është me ngjyrë të zezë. Pelerina në pjesën përpara në anën e majtë sipër, ka stemën e bashkisë dhe në pjesën prapa do të ketë mbishkrimin “POLICIA BASHKIAKE”. Pelerina e shiut duhet të ketë prerje pardsyje, e padepërtueshme nga uji, era dhe me kapuç të lëvizshëm.



Pamja përpara



Pamja prapa

Doreza ngjyrë të zezë.



2. UNIFORMA SHËRBIMI VERORE

Kostum uniforme (xhaketë, pantallona, këmbishë, kravatë, kapelë, këpucë).



Pantallona ngjyrë blu e errët. Pantallonat duhet të pajisen me dy xhepa të përparmë diagonal dhe me një xhep të pasme. Ky model shërben edhe për stërvitje.




Pamja përpara Pamja prapa


Fund ngjyrë blu e errët për punonjëset femra. Konstruksioni i fundit, duhet të jetë sipas modelit klasik, me gjatësi deri në mes të kupës së gjurit.



Këmishë me mëngë të shkurtra ngjyrë e kaltër. Këmisha në pjesën e supeve ka 2 spaleta për montimin e shenjave të supit. Mbyllja e këmbishës bëhet me 7 kopsa të vogla. Në krahun e majtë vendoset stema e bashkisë. Në krahun e djathtë sipër vendoset shenja e gjoksit. Këmisha për femra është e njëjtë përveç modelimit, i cili duhet të jetë për femra me kopsat në anën e majtë.



Këpucë gjysma verore (për meshkuj e femra), ngjyrë e zezë, me lidhëse për punonjësit meshkuj dhe me takë për punonjëset femra.



Për meshkuj



Për femra

Kapelë tip sportive me ngjyrë blu e errët me stemën e bashkisë në mes dhe mbishkrimin “POLICIA BASHKIAKE”.



Pamja anash



Pamja përpara



Pamja anash

Bluzë me mëngë të shkurtra e trikotuar, e hapur në mes dhe mbyllet përpara me tri kopsa të vogla. Pjesa poshtë është ngjyrë blu e errët së bashku me jakën, ndërsa pjesa sipër e kaltër. Në krahun e majtë vendoset stema e bashkisë, ndërsa përpara në krahun e djathtë sipër, vendoset shenja e gjoksit dhe poshtë saj mbishkrimi “POLICIA BASHKIAKE”. Ky mbishkrim është dhe në pjesën prapa. Bluza për femra është e njëjtë përveç modelimit, i cili duhet të jetë për femra me kopsat në anën e majtë.



Pamja përpara

Pamja prapa

Përdoruesit e biçikletave (pantallona, bluzë, atlete).



Bluzë me mëngë të shkurtra ngjyrë e bardhë, e trikotuar, shoqëruar me ngjyrë blu të errët në pjesën e supëve. Ka dy spaleta për vendosjen e shenjave të supit, e hapur në mes dhe jakë të zezë. Mbyllja përpara bëhet me tri kopsa të vogla. Në krahun e djathtë sipër, vendoset shenja e gjoksit dhe poshtë saj mbishkrimi “POLICIA BASHKIAKE”. Ky mbishkrim vendoset dhe në pjesën prapa. Në krahun e majtë vendoset stema e bashkisë. Bluza për femra është e njëjtë, përveç modelimit, i cili duhet të jetë për femra me kopsat në anën e majtë.

Pantallona të shkurtra ngjyrë blu të errët. Pantallonat kanë dy xhepa të përparmë diagonal, dy xhepa në pjesën e poshtme me kapak ngjyrë të kaltër dhe dy xhepa të pasme. Pantallonat për femra janë të njëjta, përveç modelimit, i cili duhet të jetë për femra me kopsat në anën e majtë.



Pamja përpara

Pamja prapa

Atlete ngjyrë blu të errët me lidhëse.



Bluzë e brendshme verore ngjyrë e zezë me jakë rrethore, e trikotuar. Në pjesën përpara do të jetë stema e bashkisë, ndërsa në pjesën prapa mbishkrimi “POLICIA BASHKIAKE”. Ky model shërben edhe për stërvitje.



Pamja përpara



Pamja prapa

Rrip mesi ngjyrë e zezë, me tokëz metalike katrore. Gjatësia dhe gjerësia standarde.



Jelek fosforeshent ngjyrë e verdhë me dy shirita të bardhë dhe të kaltër në formë kuadrati. Shiritat janë të vendosur horizontalisht. Në pjesën përpara në krahun e majtë vendoset mbishkrimi “POLICIA BASHKIAKE”, ndërsa në krahun e djathtë vendoset shenja e gjoksit.



3. UNIFORMA CEREMONIALE

Kostum uniforme (xhaketë, pantallona, këmbishë, kravatë, kapelë, këpucë, shiritat, dorezat, rrip mesi + rrip krahëqafë).





Xhaketa e kostumit të uniformës do të jetë **blu e errët**, me spaleta për vendosjen e shenjave të supit dhe katër kopsa. Ka katër xhepa me kapak (dy xhepa të vegjël në pjesën e gjoksit dhe dy xhepa të mëdhenj të poshtëm). Te jaka vendoset elementi kryesor i stemës së bashkisë. Në krahun e majtë vendoset stema e bashkisë. Xhaketa e uniformës për femra është e njëjtë përveç modelimit, i cili duhet të jetë për femra, me kopsat në anën e majtë.



Pantallonat, njëloj me xhaketën ngjyrë **blu të errët**. Pantallonat duhet të pajisen me dy xhepa të përparmë diagonal dhe me një xhep të pasmë. Konstruksioni i pantallonave për meshkuj duhet të jetë sipas modelit klasik me vijë hekurosjeje. Pantallonat për femra kanë konstruksion të njëjtë, përveç modelimit, i cili duhet të jetë për femra.




Pamja përpara Pamja prapa

Këmishë me mëngë të gjata, ngjyrë të kaltër. Këmisha në pjesën e supeve ka 2 spaleta për montimin e shenjave të supit. Mbyllja e këmishës bëhet me 7 kopsa të vogla. Në krahun e majtë vendoset stema e bashkisë. Në krahun e djathtë sipër vendoset shenja e gjoksit. Këmisha për femra është e njëjtë përveç modelimit, i cili duhet të jetë për femra me kopsat në anën e majtë. Për drejtuesin këmisha ka elemente të njëjta dhe me ngjyrë të bardhë.



Kravata blu e errët, me një shirit të hollë të kaltër dhe gjerësi max. 7–8 cm.




Kapelë blu e errët, me stemën e bashkisë në qendër, shoqëruar me shirit të gërshetuar përpara. Shiriti ngjyrë ari është për drejtorin, shiriti ngjyrë argjendi për përgjegjësin e sektorit dhe shiriti ngjyrë e kaltër për punonjës. Ka strehë plastike me ngjyrë të zezë.



Drejtuesi Përgjegjësi i sektorit Punonjësi

Shiritat janë të gërshetuara. Shiriti ngjyrë ari është për drejtuesin, shiriti ngjyrë argjendi për përgjegjësin e sektorit dhe shiriti ngjyrë e kaltër për punonjës.





Këpucë uniforme ngjyrë të zezë dhe me lidhëse.



Doreza të bardha;



Rrip mesi + rrip krahëqafë e bardhë, tokëz metalike katrore me stemën e bashkisë.



SPECIFIKIMET TEKNIKE TË SHENJAVE DALLUESE TË POLICISË BASHKIAKE

Shenjat dalluese të Policisë Bashkiake ndahen si më poshtë:

- Shenja e supit;
- Shenja e gjoksit;
- Shenja e krahut.

Elementet e shenjave dalluese duhet të jenë të rregullta, pa deformime apo shkëputje të konfiguracioneve. Paraqitja, forma dhe përshkrimi i shenjave dalluese të Policisë Bashkiake, janë si më poshtë:

A. SHENJA E SUPIT

Shenjat e supit ngjyrë blu të errët (1 palë) janë në formë spaleti me përmasa 14 cm x 5 cm. Kjo shenjë ka elementin dallues të stemës së bashkisë, shoqëruar me shirita. Shenja me tre shirita ngjyrë ari për drejtorin, me dy shirita ngjyrë argjendi për

përgjegjës të sektorit dhe me një shirit të kaltër për punonjës.



B. SHENJA E GJOKSIT

Shenja e gjoksit është në formë drejtkëndëshi me përmasa 9 cm x 4 cm. Brenda shenjës vendoset stema e bashkisë dhe numri personal. Shenja vendoset në gjoks në krahun e djathtë. Kjo shenjë është e njëjtë për drejtuesin, përgjegjës të sektorit dhe për punonjës të Policisë Bashkiake.



C. SHENJA E KRAHUT

Shenja e krahut është në formë mburoje me përmasa 8 cm x 6 cm. Shenja përmban stemën e bashkisë dhe mbi të mbishkrimin “POLICIA BASHKIAKE”. Kjo shenjë vendoset në krahun e majtë. Kjo shenjë është e njëjtë për drejtuesin, përgjegjës të sektorit dhe punonjës të Policisë Bashkiake.



LIDHJA NR. 2

KREU II
MODELI I DOKUMENTIT INDIVIDUAL
TË IDENTIFIKIMIT

1. Punonjësi i Policisë Bashkiake pajiset me dokumentin individual të identifikimit, i cili përmban:

- a) në pjesën e mbetur në sfond shkruhen fjalët: “Stema e Policisë Bashkiake”;
- b) në pjesën e sipërme në mes, vendoset mbishkrimi: “Bashkia ..., Policia Bashkiake”;
- c) në anën e djathtë, fotografinë dhe poshtë fotografisë numri i dokumentit;
- ç) në pjesën e majtë, shënohen emri, mbiemri, pozicioni;
- d) në pjesën e pasme, në të gjithë sfondin, është “Logoja e stemës së bashkisë”.

2. Përmasat e dokumentit të identifikimit janë 8,5 cm x 5,5 cm, me rumbullakim te katër cepat.



LIDHJA NR. 3

KREU III
NGJYRA, SHENJAT DHE PËRDORIMI
I MJETEVE LËVIZËSE
TË POLICISË BASHKIAKE

1. Policia Bashkiake gjatë ushtrimit të detyrës përdor mjete lëvizëse.

2. Mjetet lëvizëse janë të uniformuara dhe klasifikohen si mjete rrugore. Ato kanë këto shenja:

- a) ngjyrë të bardhë;
- b) targat e mjeteve rrugore, në përputhje me kërkesat e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë;
- c) mbishkrimet “POLICIA BASHKIAKE” vendosen në pjesët anësore, shoqëruar nga stema e bashkisë.

3. Mjetet janë me të drejtë përdorimi vetëm nga Policia Bashkiake.

VENDIM
Nr. 495, datë 24.8.2023

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
NR. 1128, DATË 30.12.2020, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR ZBATIMIN NGA
REPUBLIKA E SHQIPËRISË TË
VENDIMEVE TË KËSHILLIT TË
BASHKIMIT EVROPIAN, PËR
VENDOSJEN, NDRYSHIMIN DHE
SHFUQIZIMIN E MASAVE
SHTRËNGUESE NDËRKOMBËTARE, TË
NDRYSHUARA”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 3, pika 3, shkronja “c”, dhe 6, pikat 2 e 5, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 5, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 16, të kreut I, fjalët “... (CFSP) 2023/422 ...” zëvendësohen me “... (CFSP) 2023/1514 ...”.

2. Në aneksin 16, bashkëlidhur vendimit, vendimi (CFSP) 2023/422 zëvendësohet me vendimin (CFSP) 2023/1514, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Ngarkohen organet e parashikuara në pikën 1, të nenit 11, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, dhe në pikën 1, të nenit 7, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



VENDIM I KËSHILLIT (CFSP) 2023/1514

i datës 20 Korrik, 2023

përditësimi i listës së personave, grupeve dhe subjekteve që i nënshtrohen neneve 2, 3 dhe 4 të Pozicionit të Përbashkët 2001/931/CFSP mbi zbatimin e masave specifike për të luftuar terrorizmin dhe shfuqizimit të Vendimit (CFSP) 2023/422

Këshilli i Bashkimit Evropian,

Duke pasur parasysh Traktatin për Bashkimin Evropian, dhe në veçanti nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë,

Duke që se:

- (1) Më 27 Dhjetor 2001, Këshilli miratoi qëndrimin e përbashkët 2001/931/CFSP ⁽¹⁾.
- (2) Më 24 Shkurt 2023, Këshilli miratoi Vendimin (CFSP) 2023/422 (2), duke përditësuar listën e personave, grupeve dhe subjekteve që i nënshtrohen neneve 2, 3 dhe 4 të pozicionit të përbashkët 2001/931/CFSP ('lista').
- (3) Në përputhje me nenin 1(6) të pozicionit të përbashkët 2001/931/CFSP, është e nevojshme të rishikohen në intervale të rregullta emrat e personave, grupeve dhe subjekteve në listë për të siguruar që ka arsye për mbajtjen e tyre në të.
- (4) Ky Vendim përcakton rezultatin e rishikimit që Këshilli ka kryer në lidhje me personat, grupet dhe subjekteve për të cilat zbatohen nenet 2, 3 dhe 4 të pozicionit të përbashkët 2001/931/CFSP.
- (5) Këshilli ka verifikuar që autoritetet kompetente, siç përmendet në nenin 1(4) të pozicionit të përbashkët 2001/931/CFSP, kanë marrë vendime në lidhje me të gjithë personat, grupet dhe subjektet në listë për shkak se ata kanë qenë të përfshirë në akte terroriste sipas kuptimit të nenit 1 (2) dhe (3) të Pozicionit të Përbashkët 2001/931/CFSP. Këshilli ka arritur gjithashtu në përfundimin se personat, grupet dhe subjektet ndaj të cilëve zbatohen nenet 2, 3 dhe 4 të pozicionit të përbashkët 2001/931/CFSP duhet të vazhdojnë t'u nënshtrohen masave specifike kufizuese të parashikuara në pozicionin e përbashkët 2001/931/CFSP.

- (6) Lista duhet të përditësohet në përputhje me rrethanat, dhe Vendimi (CFSP) 2023/422 duhet të shfuqizohet, KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

Neni 1

Lista e personave, grupeve dhe subjekteve për të cilat zbatohen nenet 2, 3 dhe 4 të pozicionit të përbashkët 2001/931/CFSP është paraqitur në shtojcën e këtij vendimi.

Neni 2

Vendimi (CFSP) 2023/422 shfuqizohet.

- (1) Pozicioni i përbashkët i Këshillit 2001/931/CFSP i 27 Dhjetorit 2001 mbi zbatimin e masave specifike për të luftuar terrorizmin (OJ L 344, 28.12.2001, f. 93).
- (2) Vendimi i Këshillit (CFSP) 2023/422 i 24 Shkurtit, 2023 për përditësimin e listës së personave, grupeve dhe subjekteve që i nënshtrohen neneve 2, 3 dhe 4 të pozicionit të përbashkët 2001/931/CFSP për zbatimin e masave specifike për të luftuar terrorizmin, dhe shfuqizimin e Vendimit (CFSP) 2022/1241 (OJ L 61, 27.2.2023, f. 58).

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi një ditë pas publikimit të tij në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian. Bruksel, 20 Korrik, 2023.

*Për Këshillin**President*

J. BORRELL FONTELES



ANEKS

LISTA E PERSONAVE, GRUPEVE DHE SUBJEKTEVE TË REFERUARA NË NENIN 1

I. PERSONAT

1. ABDOLLAHI Hamed (a.k.a. Mustafa Abdullahi), i lindur më 11.8.1960 në Iran. Numri i pasaportës: D9004878.
2. AL-NASSER Abdelkanim Hussein Mohamed, lindur në Al Ihsa (Arabia Saudite), shtetas i Arabisë Saudite.
3. AL-YACCOUB Ibrahim Salih Mohammed, i lindur më 16.10.1966 në Tarut (Arabia Saudite), shtetas i Arabisë Saudite.
4. ARBABSIAR Manssor (a.k.a. Mansour Arbabsiar), i lindur më 6.3.1955 ose 15.3.1955 në Iran. Shtetasi Iranian dhe Amerikan, numri i pasaportës: C2002515 (Iran); numri i pasaportës: 477845448 (SHBA). Numri i ID-së kombëtare: 07442833, data e skadencës 15.3.2016 (patent shoferi në SHBA).
5. ASSADI Assadollah (a.k.a. Assadollah Asadi), i lindur më 22.12.1971 në Teheran (Iran), shtetas Iranian. Numri i pasaportës Diplomatike Iraniane: D9016657.
6. BOUYERI Mohammed (a.k.a. Abu Zubair, a.k.a. Sobiar, a.k.a. Abu Zoubair), i lindur më 8.3.1978 në Amsterdam (Holandë).
7. HASSAN EL HAJJ Hassan, i lindur më 22.3.1988 në Zaghdraiya, Sidon, Liban, shtetas Kanadez. Numri i pasaportës: JX446643 (Kanada).
8. HASHEMI MOGHADAM Saeid, lindur më 6.8.1962 në Teheran (Iran), shtetas Iranian. Numri i pasaportës: D9016290, i vlefshëm deri më 4.2.2019.
9. AL-DIN Hasan Izz (a.k.a. Garbaya Ahmed, a.k.a. Sa'id, a.k.a. Salwwan Samir), Liban, lindur më 1963 në Liban, shtetas i Libanit.
10. MELIAD Farah, lindur më 5.11.1980 në Sidnei (Australi), shtetas Australian. Numri i pasaportës: M2719127 (Australi).
11. MOHAMMED Khalid Sheikh (a.k.a. Ali Salem, i njohur si Bin Khalid Fahd Bin Abdallah, a.k.a. Henin Ashraf Refaat Nabith, a.k.a. Wadood Khalid Abdul), i lindur më 14.4.1965 ose 1.3.15, numri 1.4585 në Pakistan.
12. SHAHLAI Abdul Reza (a.k.a. Abdol Reza Shala'i, a.k.a. Abd-al Reza Shalai, a.k.a. Abdorreza Shahlai, a.k.a. Abdolreza Shahlai, a.k.a. Abdul-Reza Shahlade, a.k.a. Hajkj Yuaef a.k.a. ir, a.k.a. Haxhi Yusif, i njohur si Jusuf Abu-al-Karkh), i lindur rreth vitit 1957 në Iran. Adresat: (1) Kermanshah, Iran, (2) Baza Ushtarake Mehran, Provinca Ilam, Iran.
13. SHAKURI Ali Gholam, i lindur rreth vitit 1965 në Teheran, Iran.

II. GRUPET DHE SUBJEKTET

1. Organizata 'Abu Nidal' - 'ANO' (a.k.a. 'Këshilli Revolucionar i Fatahut', a.k.a. 'Brigadat Revolucionare Arabe', a.k.a. 'Shtatori i Zi', a.k.a. 'Organizata Revolucionare e Muslimanëve Socialistë').
2. Brigada e dëshmorëve të Al-Aqsa.
3. 'Al-Aqsa e.V'.
4. 'Babbar Khalsa'.
5. 'Partia Komuniste e Filipineve, duke përfshirë "Ushtrinë e Re Popullore" - "NPA", Filipine.
6. Drejtoria për Sigurinë e Brendshme të Ministrisë Iraniane për Inteligjencë dhe Siguri.



7. 'Gama'a el-Islamiyya' (a.k.a. 'Al-Gama'a al-Islamiyya') ('Grupi Islamik' - 'IG').
8. 'Islami Buyuk Dogu Akincilar Cephesi' - 'IBDA-C' ('Fronti i Madh i Luftëtarëve të Lindjes Islamike').
9. 'Hamasi', duke përfshirë ' Hamas-Izz al-Din al-Qassem'.
10. 'Krahu Ushtarak i Hizbollahut' (a.k.a. 'Krahu Ushtarak i Hizbollahut', a.k.a. 'Kragu Ushtarak i Hizbollahut', a.k.a. 'Krahu Ushtarak i Hizbollahut', a.k.a. 'Krahu Ushtarak i Hezbollahut', a.k.a. 'a. ing 'A.k.a. 'Krahu Ushtarak i Hizb Allah', a.k.a. 'Këshilli i Xhihadi' (dhe të gjitha njësitë që i raportojnë atij, duke përfshirë Organizatën e Sigurisë së Jashtme).
11. 'Hizbul Muxhahidin' - 'HM'.
12. 'Forca Khalistan Zindabad' - 'KZF'.
13. "Partia e Punëtorëve të Kurdistanit" - 'PKK' (a.k.a. 'KADEK', a.k.a. 'KONGRA-GEL').
14. 'Tigrat e Çlirimit të Tamil Eelam' - 'LTTE'.
15. 'Ejercito de Liberation National' ('Ushtria Çlirimtare Kombëtare').
16. 'Xhihadi Islamik Palestinez' – 'PIJ'.
17. 'Fronti Popullor për Çlirimin e Palestinës' – 'PFLP'.
18. "Fronti Popullor për Çlirimin e Palestinës - Komanda e Përgjithshme" (a.k.a. "PFLP - Komanda e Përgjithshme").
19. 'Devrimci Halk Kurtulus Partisi-Cephesi' - 'DHKP/C' (a.k.a. 'Devrimci Sol' ('E majta Revolucionare'), ose 'Dev Sol') ('Ushtria Revolucionare Popullore Çlirimtare/Fronti/Parti').
20. 'Sendero Luminoso' - 'SL' ('Ruga e ndritur').
21. 'Teyrbazen Azadiya Kurdistan' - 'TAK' (a.k.a. 'Skifterat e Lirisë së Kurdistanit', a.k.a. 'Skifterat e Lirisë së Kurdistanit').

**COUNCIL DECISION (CFSP) 2023/1514****of 20 July 2023****updating the list of persons, groups and entities subject to Articles 2, 3 and 4 of Common Position 2001/931/CFSP on the application of specific measures to combat terrorism, and repealing Decision (CFSP) 2023/422**

The Council of the European Union,

Having regard to the Treaty on European Union, and in particular Article 29 thereof,

Having regard to the proposal from the High Representative of the Union for Foreign Affairs and Security Policy,

Whereas:

- (1) On 27 December 2001, the Council adopted Common Position 2001/931/CFSP ⁽¹⁾.
- (2) On 24 February 2023, the Council adopted Decision (CFSP) 2023/422 ⁽²⁾, updating the list of persons, groups and entities subject to Articles 2, 3 and 4 of Common Position 2001/931/CFSP (the 'list').
- (3) In accordance with Article 1(6) of Common Position 2001/931/CFSP, it is necessary to review at regular intervals the names of persons, groups and entities in the list to ensure that there are grounds for keeping them thereon.
- (4) This Decision sets out the result of the review that the Council has carried out in respect of persons, groups and entities to which Articles 2, 3 and 4 of Common Position 2001/931/CFSP apply.
- (5) The Council has verified that competent authorities, as referred to in Article 1(4) of Common Position 2001/931/CFSP, have taken decisions with regard to all persons, groups and entities on the list to the effect that they have been involved in terrorist acts within the meaning of Article 1(2) and (3) of Common Position 2001/931/CFSP. The Council has also concluded that the persons, groups and entities to which Articles 2, 3 and 4 of Common Position 2001/931/CFSP apply should continue to be subject to the specific restrictive measures provided for in Common Position 2001/931/CFSP.
- (6) The list should be updated accordingly, and Decision (CFSP) 2023/422 should be repealed,

HAS ADOPTED THIS DECISION:

Article 1

The list of persons, groups and entities to which Articles 2, 3 and 4 of Common Position 2001/931/CFSP apply is set out in the Annex to this Decision.

Article 2

Decision (CFSP) 2023/422 is hereby repealed.

⁽¹⁾ Council Common Position 2001/931/CFSP of 27 December 2001 on the application of specific measures to combat terrorism (OJ L 344, 28.12.2001, p. 93).

⁽²⁾ Council Decision (CFSP) 2023/422 of 24 February 2023 updating the list of persons, groups and entities subject to Articles 2, 3 and 4 of Common Position 2001/931/CFSP on the application of specific measures to combat terrorism, and repealing Decision (CFSP) 2022/1241 (OJ L 61, 27.2.2023, p. 58).



Article 3

This Decision shall enter into force on the day following that of its publication in the *Official Journal of the European Union*.

Done at Brussels, 20 July 2023.

For the Council
The President
J. BORRELL FONTELLES



ANNEX

LIST OF PERSONS, GROUPS AND ENTITIES REFERRED TO IN ARTICLE 1

I. PERSONS

1. ABDOLLAHI Hamed (a.k.a. Mustafa Abdullahi), born 11.8.1960 in Iran. Passport number: D9004878.
2. AL-NASSER Abdelkarim Hussein Mohamed, born in Al Ihsa (Saudi Arabia), citizen of Saudi Arabia.
3. AL-YACIOUB Ibrahim Salih Mohammed, born 16.10.1966 in Tarut (Saudi Arabia), citizen of Saudi Arabia.
4. ARBABSAR Manssor (a.k.a. Mansour Arbabsar), born 6.3.1955 or 15.3.1955 in Iran. Iranian and US national, passport number: C2002515 (Iran); passport number: 477845448 (USA). National ID number: 07442833, expiry date 15.3.2016 (USA driving licence).
5. ASSADI Assadollah (a.k.a. Assadollah Asadi), born 22.12.1971 in Tehran (Iran), Iranian national. Iranian diplomatic passport number: D9016657.
6. BOUYERI Mohammed (a.k.a. Abu Zubair, a.k.a. Sobiar, a.k.a. Abu Zoubair), born 8.3.1978 in Amsterdam (The Netherlands).
7. HASSAN EL HAJJ Hassan, born 22.3.1988 in Zaghdraiya, Sidon, Lebanon, Canadian citizen. Passport number: JX446643 (Canada).
8. HASHEMI MOGHADAM Saeid, born 6.8.1962 in Tehran (Iran), Iranian national. Passport number: D9016290, valid until 4.2.2019.
9. AL-DIN Hasan Izz (a.k.a. Garbaya Ahmed, a.k.a. Sa'id, a.k.a. Salwwan Samir), Lebanon, born 1963 in Lebanon, citizen of Lebanon.
10. MELIAD Farah, born 5.11.1980 in Sydney (Australia), Australian citizen. Passport number: M2719127 (Australia).
11. MOHAMMED Khalid Sheikh (a.k.a. Ali Salem, a.k.a. Bin Khalid Fahd Bin Abdallah, a.k.a. Henin Ashraf Refaat Nabith, a.k.a. Wadood Khalid Abdul), born 14.4.1965 or 1.3.1964 in Pakistan, passport number 488555.
12. SHAHLAI Abdul Reza (a.k.a. Abdol Reza Shala'i, a.k.a. Abd-al Reza Shalai, a.k.a. Abdorreza Shahlai, a.k.a. Abdolreza Shahlai, a.k.a. Abdul-Reza Shahlade, a.k.a. Hajj Yusef, a.k.a. Haji Yusif, a.k.a. Hajji Yasir, a.k.a. Hajji Yusif, a.k.a. Yusuf Abu-al-Karkh), born circa 1957 in Iran. Addresses: (1) Kermanshah, Iran, (2) Mehran Military Base, Ilam Province, Iran.
13. SHAKURI Ali Gholam, born circa 1965 in Tehran, Iran.

II. GROUPS AND ENTITIES

1. 'Abu Nidal Organisation' – 'ANO' (a.k.a. 'Fatah Revolutionary Council', a.k.a. 'Arab Revolutionary Brigades', a.k.a. 'Black September', a.k.a. 'Revolutionary Organisation of Socialist Muslims').
2. 'Al-Aqsa Martyrs' Brigade'.
3. 'Al-Aqsa e.V.'.
4. 'Babbar Khalsa'.



5. 'Communist Party of the Philippines', including 'New People's Army' – 'NPA', Philippines.
6. Directorate for Internal Security of the Iranian Ministry for Intelligence and Security.
7. 'Gama'a al-Islamiyya' (a.k.a. 'Al-Gama'a al-Islamiyya') ('Islamic Group' – 'IG').
8. 'İslami Büyük Doğu Akıncılar Cephesi' – 'İBDA-C' ('Great Islamic Eastern Warriors Front').
9. 'Hamas', including 'Hamas-Izz al-Din al-Qassem'.
10. 'Hizballah Military Wing' (a.k.a. 'Hezbollah Military Wing', a.k.a. 'Hizbullah Military Wing', a.k.a. 'Hizbollah Military Wing', a.k.a. 'Hezbollah Military Wing', a.k.a. 'Hisbollah Military Wing', a.k.a. 'Hizbu'llah Military Wing' a.k.a. 'Hizb Allah Military Wing', a.k.a. 'Jihad Council' (and all units reporting to it, including the External Security Organisation)).
11. 'Hizbul Mujahideen' – 'HM'.
12. 'Khalistan Zindabad Force' – 'KZF'.
13. 'Kurdistan Workers' Party' – 'PKK' (a.k.a. 'KADEK', a.k.a. 'KONGRA-GEL').
14. 'Liberation Tigers of Tamil Eelam' – 'LTTE'.
15. 'Ejército de Liberación Nacional' ('National Liberation Army').
16. 'Palestinian Islamic Jihad' – 'PIJ'.
17. 'Popular Front for the Liberation of Palestine' – 'PFLP'.
18. 'Popular Front for the Liberation of Palestine – General Command' (a.k.a. 'PFLP – General Command').
19. 'Devrimci Halk Kurtuluş Partisi-Cephesi' – 'DHKP/C' (a.k.a. 'Devrimci Sol' ('Revolutionary Left'), a.k.a. 'Dev Sol') ('Revolutionary People's Liberation Army/Front/Party').
20. 'Sendero Luminoso' – 'SL' ('Shining Path').
21. 'Teyrbazen Azadiya Kurdistan' – 'TAK' (a.k.a. 'Kurdistan Freedom Falcons', a.k.a. 'Kurdistan Freedom Hawks').



VENDIM

Nr. 496, datë 24.8.2023

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 111, DATË 1.3.2023, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
BUXHETIT TË AGJENCISË
SHTETËRORE TË KADASTRËS,
PËR VITIN 2023”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shtojcat 2 dhe 3, të përmendura në pikën 1 dhe bashkëlidhur vendimit nr. 111, datë 1.3.2023, të Këshillit të Ministrave, zëvendësohen me shtojcat me të njëjtin emërtim dhe numërtim, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA NR. 2

BUXHETI I AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS 2023

000/lekë

PËRSHKRIMI	Buxheti Janar- Dhjetor 2023	
	Të Ardhura	Shpenzime
Të ardhura nga Shërbimet +Parcela ndertimore+Të tjera	5,585,253	
<i>Te ardhura nga buxheti i shtetit</i>	517,159	
Shpenzime personeli		2,939,323
Shpenzime korente		567,913
Shpenzime kapitale, nga te cilat		2,490,476
<i>Per projektin e Qendrës e Kadastrës Dixhitale</i>		517,159
Fondi rezervë		104,700
Total buxheti ASHK	6,102,412	6,102,412



SHTOJCA NR. 3

BUXHETI I AGJENCISË SHETETËRORE TË KADASTRËS 2023

000/lekë

Nr.	EMËRTIMI	Buxheti i rishikuar 2023
I	TOTALI I TË ARDHURAVE	6,102,412
1	Të ardhura nga shërbimet	1,800,000
2	Të ardhura nga transferimi I parcelës ndërtimore	300,000
3	Të ardhura të tjera	280,000
4	Fonde që trashëgoohen nga viti 2022	3,205,253
5	Fonde te transferuara nga buxheti i shtetit	517,159
II	TOTALI I SHPENZIMEVE	6,102,412
1	Shpenzime personeli	2,939,323
1	Paga për punonjësit sipas strukturës organike të propozuar	1,723,434
2	Kontribute për Sigurime Shoqërore për punonjësit në organikë	286,719
3	Paga për punonjësit me kontratë të propozuar	722,364
4	Kontribute për Sigurime Shoqërore për punonjësit me kontratë	120,635
5	Fondi i vecantë i pagave	86,172
2	Shpenzime operative	567,913
1	Shpenzime për mallra dhe shërbime	567,913
3	Shpenzime Kapitale	2,490,476
a	Shpenzime kapitale për projektin për Qendren e Kadastrore Dixhitale	517,159
b	Shpenzime kapitale për investime të patrupëzuara	643,398
c	Investime kapitale të trupëzuara(Rikonstruksion +Infrastruktura IT)	1,329,919
1	Rikonstruksione (Drejtoria Vendore të ASHK-se Tiranë+Vlorë+Kukës etj)	826,605
2	Infrastruktura e sistemeve të IT+ blerje paisje	448,313
3	Orendi	55,000
4	Fondi Rezervë	104,700
	TË ARDHURA (-) SHPENZIME(te ardhura të pashperndara)	0

**VENDIM**

Nr. 497, datë 24.8.2023

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES
NDRYSHUESE NR. 2 TË MARRËVESHJES SË
GRANTIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE SUEDISË, NË LIDHJE ME
PLANIFIKIMIN E SEKTORIT TË UJIT PËR
NEGOCIATAT ME BASHKIMIN EVROPIAN,
TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 93, DATË
5.2.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese nr. 2 të marrëveshjes së grantit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Suedisë, në lidhje me planifikimin e sektorit të ujit për negociatat me Bashkimin Evropian, të miratuar me vendimin nr. 93, datë 5.2.2020, të Këshillit të Ministrave, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**NDRYSHIMI I MARRËVESHJES
SË GRANTIT**

**PËR PLANIFIKIMIN E SEKTORIT TË UJIT
PËR NEGOCIATAT ME BE-në NDËRMJET
SUEDISË DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Nr. i kontributit të Sida-s 13092A0101

Ndryshimi nr. 2

Suedia, e përfaqësuar nga Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SIDA);

dhe

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë,

kanë nënshkruar këtë Marrëveshje në datën 19 dhjetor 2019, në lidhje me planifikimin e sektorit të ujit për negociatat me BE-në.

Palët kanë vendosur të ndryshojnë Marrëveshjen siç parashikohet në nenet e mëposhtme.

Kushtet e pandryshuara në Marrëveshje vijojnë të mbeten të njëjta.

Ndryshimet e Marrëveshjes

Neni 1, 2, 7, 19 dhe 20, si dhe shtojca B e Marrëveshjes së lartpërmendur ndryshohen si në vijim.

Neni 1**Objekti dhe historiku****Në vend të:**

1.1 Në vitin 2006, Shqipëria dhe Suedia nënshkruan një Marrëveshjeve mbi Kushtet dhe Afatet e Përgjithshme për Zhvillim dhe Bashkëpunim. Suedia ka vendosur të japë një kontribut në formë granti, i cili do të përdoret vetëm për qëllime të zbatimit të projektit “Planifikimi i sektorit të ujit për negociatat me BE-në”. Projekti do të zbatohet gjatë një periudhe 36-mujore, duke filluar nga data kur kjo Marrëveshje hyn në fuqi.

Duhet të ketë tekstin e mëposhtëm:

1.1 Në vitin 2006, Shqipëria dhe Suedia nënshkruan një Marrëveshje mbi Kushtet dhe Afatet e Përgjithshme për Zhvillim dhe Bashkëpunim. Suedia ka vendosur të japë një kontribut në formë granti, i cili do të përdoret vetëm për qëllime të zbatimit të projektit “Planifikimi i sektorit të ujit për negociatat me BE-në”. Projekti do të zbatohet duke filluar nga data kur kjo Marrëveshje hyn në fuqi dhe deri në datën 31 dhjetor 2024.

Neni 2**Objektivat e Projektit****Në vend të:**

2.1 Dokumenti i Projektit, përfshirë Kornizën e Rezultateve, si dhe buxheti në monedhën Euro mund të përditësohen nëpërmjet ndryshimeve me shkrim, sa herë që bëhet një ndryshim i rëndësishëm, në mënyrë që Marrëveshja të zbatohet në mënyrë efektive.

Duhet të ketë tekstin e mëposhtëm:

2.2 Dokumenti i Projektit, përfshirë Kornizën e Rezultateve, si dhe buxheti mund të përditësohen nëpërmjet ndryshimeve me shkrim, sa herë që bëhet



një ndryshim i rëndësishëm, në mënyrë që Marrëveshja të zbatohet në mënyrë efektive.

Neni 7 Raportimi financiar

Në vend të:

7.1 Përfituesi, nëpërmjet AKUM-it, përgatit dhe i dorëzon Suedisë pasqyrat financiare gjashtëmujore dhe raportet financiare për Projektin, jo më vonë se datat 31 mars dhe 30 shtator të çdo viti. Raporti i parë financiar për vitin 2019 dorëzohet jo më vonë se data 31 mars 2020. Raporti financiar përfundimtar mbulon periudhën nga data 1 korrik 2019 deri më 31 dhjetor 2022 dhe nuk dërgohet më vonë se data 30 qershor 2022.

Duhet të ketë tekstin e mëposhtëm:

7.1 Përfituesi, nëpërmjet AKUM-it, përgatit dhe i dorëzon Suedisë pasqyrat financiare vjetore dhe raportin financiar për Projektin, jo më vonë se data 31 mars të çdo viti. Për vitet 2022, 2023 dhe 2024, Përfituesi gjithashtu, nëpërmjet AKUM-it, përgatit dhe i dorëzon Suedisë një raport financiar gjashtëmujor për Projektin, jo më vonë se data 30 shtator, i cili mbulon përkatësisht periudhën janar–qershor të çdo viti.

Neni 19 Përfundimi i Marrëveshjes

Në vend të:

19.1 Kjo Marrëveshje mbetet në fuqi deri në 36 muaj pas hyrjes në fuqi, përveç rasteve kur përfundon më herët nëpërmjet një njoftimi me shkrim gjashtë muaj para nga njëra prej Palëve.

Duhet të ketë tekstin e mëposhtëm:

19.1 Kjo Marrëveshje mbetet në fuqi deri në datën 30 qershor 2025, përveç rasteve kur përfundon më herët nëpërmjet një njoftimi me shkrim gjashtë muaj para nga njëra prej Palëve.

Neni 20 Periudha e vlefshmërisë së Marrëveshjes

Në vend të:

20.1 Marrëveshja hyn në fuqi pas njoftimit me shkrim të Përfituesit për përfundimin e procedurave të saj të brendshme dhe mbetet në fuqi deri në 36

muaj pas fillimit të saj, përveç rasteve kur zgjidhet në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, ose deri në kthimin e fondeve të pashfrytëzuara të SIDA-s dhe përmbushjen e kërkesave të raportimit të kësaj Marrëveshjeje, kohë në të cilën kjo Marrëveshje përfundon.

Duhet të ketë tekstin e mëposhtëm:

20.1 Marrëveshja hyn në fuqi pas njoftimit me shkrim të Përfituesit për përfundimin e procedurave të saj të brendshme dhe mbetet në fuqi deri në datën 30 qershor 2025, përveç rasteve kur zgjidhet në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, ose deri në kthimin e fondeve të pashfrytëzuara të SIDA-s dhe përmbushjen e kërkesave të raportimit të kësaj Marrëveshjeje, kohë në të cilën kjo Marrëveshje përfundon.

Shtojcat

Shtojca B e Marrëveshjes së Grantit, Buxheti i Projektit, zëvendësohen me buxhetin e rishikuar të Projektit, datë 22.11.2022, bashkëlidhur këtij ndryshimi.

Hyrja në fuqi e këtij ndryshimi

Ky ndryshim i Marrëveshjes hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të fundit.

Janë nënshkruar dy kopje origjinale të këtij ndryshimi, nga të cilat palët kanë marrë një kopje.

Tiranë, 2023.6.14

Në emër të Suedisë, e përfaqësuar nga Agjencia
Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe
Bashkëpunim (SIDA)

Nënshkrimi
Elsa Hastad,
AMBASADOR

26.6.2023

Në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës
së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e
Financave dhe Ekonomisë

Nënshkrimi
Delina Ibrahimaj,
MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË



**BUXHETI I RISHIKUAR SHTOJCA B, E PROJEKTTIT TË GRANTIT, PROJEKTI NIPS I UJËSJELLËSIT
PROJEKTI PËR MBËSHETJETEN E MARRËVESHJES SË UJËSJELLËSIT DHE PLANIFIKIMIT TË INVESTIMEVE (UJËSJELLËSI NIPS)**

Projekti i përgjithshëm (maksimumi) SEK, siç përcaktohet në Marrëveshjen e Grantit (Nr. i kontributit të SIDA-s 13092A0101, Nen. 4.1) 20.000.000

	Buxheti i Projektit, menaxhuar nga AKUM-i		Shuma (SEK)	Vlera €	Buxheti fillestar	Buxheti i rishikuar	Rezultate 2021	Buxheti 2022	Buxheti 2023	Buxheti 2024
1,0	Kontrata kryesore e konsulencës		16.960.000		16960000	16960000	3188250	5915750	6.329.000	1527000
2,0	Njësia e Projektit të AKUM-it		778.400	69500	778400	627200	-	200.400	275600	151200
3,0	Zgjatja e projektit					2.000.000	-		1.400.000	600000
4,0	Kontigjenca		2.261.600		2.261.600	412.800				
	Buxheti i plotë i projektit				20.000.000	20.000.000	3.188.250	6.116.150	8.004.600	2.278.200
1,0	Buxheti kryesor i konsulencës		Kostoja për njësi (ditë, SEK)	Numri i njësive (ditë SEK)	Vlera Totale (SEK)					
1,1	Eksperti kryesor - Drejtuesi i grupit		11.000	400	4.400.000					
1,2	Eksperti kryesor- Ekspert i lartë për ujësjellësin		11.000	200	2.200.000					
1,3	Eksperti kryesor- Ekspert i lartë për ujërat e zeza		11.000	120	1.320.000					
1,4	Ekspertët jo kryesorë - Ekspert i lartë specialist (SPE)		10.000	300	3.000.000					
1,5	Ekspertët jo kryesorë/ekspert i lartë		3.250	1000	3.250.000					
	Tarifat totale (përfshirë shpenzimet e përgjithshme)				14.170.000	14.170.000	3.188.250	5.313.750	4.251.000	1.417.000
1,6	Dispozita për shpenzime të rastësishme				2.460.000	2.460.000	0	492.000	1.968.000	
1,7	Dispozita për verifikimin/auditimin e shpenzimeve				330.000	330.000	0	110.000	110.000	110.000
					16.960.000	16.960.000	3.188.250	5.915.750	6.329.000	1.527.000
2,0	Buxheti i njësive së projektit të AKUM-it	Kosto për njësi (€)								
2,1	Stafi, mbështetja administrative, ekuivalente me dy (2) nëpunës të rinj	1.500	16.800	24		403.200	0	50.400	201.600	151.200
2,2	Mbështetja për zyrë, printimi, udhëtimi	20.000	224.000	1		224.000	0	150.000	74000	
	Buxheti total i njësive së projektit				778.400	627.200	-	200.400	275.600	151.200
3,0	Zgjatja e projektit				Vlera totale(SEK)					
	Buxheti i parashikuar zgjatja e Projektit				-	2.000.000			1.400.000	600.000
4,0	Buxheti i kontingjentit				Vlera totale(SEK)					
	Kontigjenca e projektit***				2.261.600	412.800				

Shpjegime dhe supozime:

*Shënim. Aty ku vlerat € janë të parashikueshme në Marrëveshjen e Grantit ose Kontratën e Konsulentit ato konvertohen për planifikim kundrejt kursit të këmbimit 11,2 SEK 1€

Norma e përdorur	11.2
------------------	------

** Shënimi 2. Kontigjenca për planifikim ka përdorur vlerën totale të grantit minus vlerën totale të komponentëve të tjerë.

** Shënimi 3: Kontingjent mund të përdoret pa kundërshtim vetëm me miratimin e Bordit dhe Sid.



Plani i pagesave (SEK)													
Data	1.9.2021	25.10.2021	15.3.2022	15.3.2022	25.8.2022	30.9.2022	Dhjetor-22	Mars-23	Qershor-23	Shtator-23	Dhjetor-23	2024	2025
Pagesat e tarifave	Pagesa 1 (paradhënie)	Pagesa 1	Pagesa 2	Pagesa 3	Pagesa 4	Pagesa 5	Pagesa 6	Pagesa 7	Pagesa 8	Pagesa 9	Pagesa 10	Pagesa përfundimtare pas raportit përfundimtar	
Vlera	2.125.500	1062750	1062750	1062750	1062750	1062750	1062750	1062750	1062750	1062750	1062750	1417000	
Rastet							492.000	492000	492000	492000	492000		
Auditimi					82.500				82500			82500	82500
Shënim.	Rastet dhe periudhat e parashikuara të shpenzimeve të auditimit.												



VENDIM
Nr. 498, datë 24.8.2023

PËR MIRATIMIN E
DËMSPËRBLIMIT FINANCIAR
PËR DISA ISH-TË DËNUAR POLITIKË
TË REGJIMIT KOMUNIST

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9 e 10, të ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007, “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e dëmshpërblimit financiar për disa ish-të dënuar politikë të dënuar me burgim, izolim në hetuesi, izolim në institucion mjekësor apo mjekësor psikiatrik, sipas listës së përcaktuar në aneksin A, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Miratimin e dëmshpërblimit financiar për ish-të dënuar politikë të dënuar me dënim kapital ose të ekzekutuar pa gjyq, sipas listës së përcaktuar në aneksin B, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Shpërndarja e masës së dëmshpërblimit për ish-të dënuarit politikë bëhet me këste, sipas kritereve dhe kufijve të përcaktuar në nenin 12, të ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007, “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar.

4. Shuma e përlogaritur përballohet nga buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale i planifikuar për këtë qëllim. Shuma transferohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bankën e nivelit të dytë nëpërmjet thesarit, pas konfirmimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Pagesa e dëmshpërblimit për secilin përfutues urdhërohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në llogaritë e tyre personale, të hapura në bankat e nivelit të dytë, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007, “Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar.

5. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Aneksi A

Nr. Rendor	Nr. Dosjes	Data e dosjes individuale	Emër	Mbiemër	Atësi	Amësi	Datëlindja	Vendlindja	Gjinia	Perioda e plotë e vuajtjes së dënimit	Shuma e dëmshpërblimit në lekë	Përfutimet nga ligje të mëparshme		Enti Kombëtar i Banesave	ASHK	Dëmshpërblimi përfundimtar në lekë
												Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Letra me Vlerë			
1	12192	10.07.2008	Gjyso	Sadkaj	Shefit	Halime	12.02.1917	Cakran, Fier	M	2 vjet 2 muaj 6 ditë	1,596,000	200,000	0	0	0	1,396,000
2	12640	25.07.2008	Muht	Hoxha	Ilmi	Valide	01.10.1944	Peshkopi	M	1 vit 1 muaj 28 ditë	848,000	0	0	0	0	848,000
3	12837	01.08.2008	Iljas	Sejani	Teha	Hasime	26.02.1910	Delvinë, Sarandë	M	7 vjet 9 muaj 16 ditë	5,700,000	0	895,000	0	0	4,805,000
4	13309	25.08.2008	Pavlo	Memo	Ziso	Anastasia	15.06.1920	Sarandë	M	5 vjet 11 muaj 27 ditë	4,386,000	100,000	123,489	0	0	4,162,511
5	17815	08.05.2009	Neim	Haxhiu	Selfo	Zarife	11.01.1912	Dhërblan, Tepelenë	M	1 vit 3 muaj dhe 24 ditë	960,000	0	129,534	0	0	830,466
6	19162	08.05.2009	Vangel	Dhjamand	Anastas	Maro	25.10.1987	Mursi, Sarandë	M	2 vjet 4 muaj 25 ditë 8 vjet 30 ditë	7,658,000	0	967,233	0	0	6,690,767
7	20735	20.06.2009	Prel	Smajelaj (Gjergji)	Tom	Lenë	11.03.1929	Nikç, Shkoder	M	7 vjet 27 ditë	5,166,000	200,000	745,464	0	0	4,220,536
																22,953,280

Aneks B

Nr.	Nr. i dosjes	Data e dosjes individuale	Emër	Mbiemër	Atësi	Amësi	Datëlindja	Vendlindja	Gjinia	Viti i vdekjes	Shuma e dëmshpërblimit në lekë	Përfutimet nga ligje të mëparshme				Dëmshpërblimi përfundimtar në lekë
												Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Letra me Vlerë	Enti Kombëtar i Banesave	ASHK	
1	15506	19.11.2008	Razip	Zenelaj	Zeqir	Dyzelbi	12.04.1915	Vajzë, Vlorë	M	20.08.1947	5,840,000	200,000	718,560	0	0	4,921,440
2	21438	08.04.2011	Ali	Denko (Panarit)	Selfo	Mahmude	20.01.1906	Panarit	M	30.11.1944	5,840,000	200,000	720,000	0	0	4,920,000
																9,841,440



VENDIM

Nr. 499, datë 24.8.2023

PËR NJË NDRYSHIM NË Vendimin NR. 23, DATË 18.1.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR FINANCIMIN E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE SPITALORE NGA SKEMA E DETYRUESHME E SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR, PËR VITIN 2023”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar; të nenit 10, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shtojca nr. 2, bashkëlidhur vendimit nr. 23, datë 18.1.2023, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me shtojcën nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA NR. 2

BUXHETI I SHËRBIMIT SPITALOR 2023

INSTITUCIONET	BUXHETI NË 000 LEKË SIPAS ARTIKUJVE						TOTALI
	ART. 600	ART. 601	ART. 602	ART. 602 PPP LABORATORË	ART. 604	REZERVË	
BERAT	363,000	60,000	170,000	57,200			650,200
BULQIZË	96,700	16,100	30,000				142,800
DELVINË	41,500	6,850	7,000				55,350
DEVOLL	57,500	9,630	12,000				79,130
DIBËR	314,600	52,450	125,000	31,000			523,050
ELBASAN	539,100	89,800	235,000	90,000			953,900
FIER	442,650	73,350	214,750	110,000			840,750
GRAMSH	140,000	23,100	32,000				195,100
GJIROKASTËR	263,700	43,700	110,000	33,500			450,900
HAS	53,200	8,810	15,000				77,010
KAVAJË	136,700	22,600	32,000				191,300
KOLONJË	93,400	15,400	20,000				128,800
KORÇË	488,900	81,200	270,000	79,000			919,100
KRUJË	142,900	23,600	30,000				196,500
KUÇOVË	77,800	12,750	18,000				108,550
KUKËS	316,000	52,100	120,000	31,100			519,200
KURBIN	105,400	17,600	37,000				160,000
LEZHË	313,500	52,100	140,000	58,200			563,800
LIBRAZHID	182,200	30,100	53,000				265,300
LUSHNJË	265,700	43,900	105,000	46,000			460,600
MALËSI E MADHE	25,700	4,280	6,500				36,480
MALLAKASTËR	48,000	7,900	13,000				68,900
MAT	156,900	25,900	35,000				217,800
MIRDITË	126,900	19,500	29,000				175,400
PEQIN	41,400	6,900	7,500				55,800
PËRMET	96,900	16,120	35,000				148,020
POGRADEC	196,900	32,600	80,000				309,500



PUKË	106,800	17,600	38,000				162,400
SARANDË	183,700	30,200	110,000	33,400			357,300
SKRAPAR	90,000	14,970	17,000				121,970
SHKODËR	655,600	108,500	275,000	66,500			1,105,600
TEPELENË	106,800	17,500	16,000				140,300
QSUT	2,913,900	480,625	4,164,115	810,000			8,368,640
SUOGJ “MBRETËRESHA GERALDINË”	353,500	58,200	250,000	36,800			698,500
SUOGJ “KOÇO GLIOZHENT”	291,100	48,200	260,000	33,000			632,300
SU “SHEFQET’NDROQI”	477,200	78,250	560,000	59,200			1,174,650
SU TRAUMA	171,700	28,200	230,000	55,200			485,100
TROPOJË	122,800	20,300	35,000				178,100
VLORE	474,400	78,150	324,750	71,500			948,800
“MEMORIAL” FIER					1,029,300		1,029,300
DURRËS				73,000	1,177,000		1,250,000
Paketat e shërbimeve					1,630,060		1,630,060
Transferta për individët (mjekë specialistë)					50,000		50,000
Trajtime me VKM					30,000		30,000
Pagesat e shërbimeve PPP					2,625,000		2,625,000
Rezervë				25,200		1,514,540	1,539,740
TOTAL	11,074,650	1,829,035	8,261,615	1,799,800	6,541,360	1,514,540	31,021,000

VENDIM
Nr. 500, datë 24.8.2023

PËR PËRJASHTIMIN NGA NDALIMI I
GJUETISË, PËR QËLLIME SHKENCORE
PASVAKSINALE, TË KAFSHËVE TË
VAKSINUARA, NË KUADËR TË
PROJEKTIT IPA 2020, KONTROLLIN
DHE ÇRRËNJOSJEN E SËMUNDJES SË
TËRBIMIT – FAZA IV

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1, shkronja “b”, e 2, të nenit 4, të ligjit nr. 60/2022, “Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përrjashtimin nga ndalimi i gjuetisë, duke lejuar gjuetinë e dhelprës së kuqe, për qëllime shkencore pasvaksinale, në kuadër të projektit IPA 2020, “Kontrollin dhe çrrënjosjen e sëmundjes së tërbimit – faza IV”, financuar nga Bashkimi Evropian.

2. Gjuetia e dhelprës së kuqe për marrjen e kampionëve të dhelprës kryhet në të gjithë territorin e vendit, me përjashtim të territorit të zonave të mbrojtura mjedisore, përgjatë muajve shtator,

nëntor dhe dhjetor 2023. Brenda kësaj periudhe, gjuetia të kryhet vetëm në ditët e mërkurë, e enjte, e premte dhe e shtunë.

3. Për marrjen e kampionëve të dhelprave të kuqe, nëpërmjet gjuajtjes së tyre, të angazhohen në të gjithë vendin 39 (tridhjetë e nëntë) punonjës të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, të pajisur me shenjë dalluese për këtë proces, për sigurimin në total të 324 (treqind e njëzet e katër) kampionëve të dhelprave të kuqe.

Numri i personave, që realizojnë marrjen e kampionëve në çdo qark, si dhe numri i kampionëve të dhelprave që sigurohen për secilin qark, jepen në shtojcën që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Detajimi i punonjësve përkatës, që marrin pjesë në këtë proces, bëhet nga drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura. Analizimi i kampionëve të dhelprës së kuqe bëhet nga Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare.

4. Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, pajis me autorizimin përkatës për kryerjen e gjuetisë së dhelprës së kuqe për çdo qark, punonjësit e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, që marrin pjesë në këtë proces.

5. Gjatë të gjithë kohës së kryerjes së kësaj veprimtarie në zonat ku do të kryhet gjuetia dhe marrja e kampionëve nga dhelprat, procesi kontrollohet nga strukturat vendore përgjegjëse për



pyjet në njësitë e vetëqeverisjes vendore, shërbimet veterinare përkatëse dhe Policia e Shtetit.

6. Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të bashkëpunojë me Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, në lidhje me pajisjen e punonjësve të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura me pajisje (frigobokse) për ruajtjen e kampionëve (kokat e dhelprave). Punonjësit e Agjencisë Rajonale të Zonave të Mbrojtura, pas marrjes së kampionëve (kokat e dhelprave), t'i dorëzojnë këto të fundit pranë shërbimit veterinar rajonal përkatës.

7. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural koordinon procesin për marrjen e kampionëve të dhelprave të kuqe, dërgimin e tyre në laboratorët përkatës, analizimin dhe nxjerrjen e rezultateve, si

dhe raportimin për përfundimin e kësaj faze të procesit të monitorimit pasvaksinal kundër sëmundjes së tërbimit të dhelprës së kuqe në Shqipëri.

8. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Brendshme, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare, Drejtoria e Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCË

PËR PËRJASHTIMIN NGA NDALIMI I GJUEËTISË, PËR QËLLIME SHKENCORE PASVAKSINALE TË KAFSHËVE TË VAKSINUARA, NË KUADËR TË PROJEKTIT IPA2020, KONTROLLI DHE ÇRRËNJOSJA E SËMUNDJES SË TËRBIMIT – FAZA IV

NUMRI I GJUEËTARËVE PËR SIGURIMIN E KAMPIONEVE LABORATORIKE, NUMRI I KAMPIONEVE TË DHELPRAVE TË KUQE

Nr.	Qarku	Bashkia	Nr. i punonjësve në qark	Nr. i kampionëve të dhelprave të kuqe	
				Qark	Bashki
1	BERAT		5	21	
		Berat			12
		Kuçovë			2
		Skrapar			3
		Poliçan			2
		Ura Vajgurore			2
2	DIBËR		3	24	
		Dibër			10
		Bulqizë			7
		Mat			4
		Klos			3
3	DURRËS		3	10	
		Durrës			3
		Shijak			3
		Krujë			4
4	ELBASAN		3	37	
		Elbasan			8
		Belsh			4
		Vërrik			4
		Librazhd			5
		Përrenjas			4
		Peqin			4
		Gramsh			8
5	FIER		4	24	



		Fier			6
		Lushnjë			6
		Divjakë			3
		Roskovec			2
		Mallakastër			4
		Patos			3
6	GJIROKASTËR		2	38	
		Gjirokastër			12
		Libohovë			5
		Tepelenë			6
		Memaliaj			4
		Përmet			7
		Këlcyrë			2
		Dropull			2
7	KORÇË		4	53	
		Korçë			14
		Maliq			5
		Devoll			4
		Pustec			3
		Kolonjë			14
		Pogradec			13
8	KUKËS		1	20	
		Kukës			8
		Tropojë			11
		Has			1
9	LEZHË		5	12	
		Lezhë			3
		Kurbini			3
		Mirditë			6
10	SHKODËR		2	36	
		Shkodër			12
		Vau i Dejës			4
		Malësi e Madhe			14
		Pukë			4
		Fushë-Arrëz			2
11	TIRANË		5	13	
		Tiranë			4
		Vorë			2
		Kamzë			2
		Kavajë			3
		Rrogozhinë			2
12	VLORË		2	36	
		Vlorë			20
		Sarandë			2
		Konispol			2
		Finiq			4
		Delvinë			4
		Himarë			2
		Selenicë			2
	TOTALI		39	324	

**VENDIM**

Nr. 501, datë 24.8.2023

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË
KULTURËS TË PRONËS ME
EMËRTIMIN “KALAJA E LËKURËSIT”,
ME NUMËR PASURIE 26/144, 26/139,
26/487, ZONA KADASTRALE 8642,
SARANDË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Kulturës të pronës me emërtimin “Kalaja e Lëkurësit”, Sarandë, me numër pasurie 26/144, 26/139, 26/487, zona kadastrale 8642, e llojit “truall”, me sipërfaqe totale 8211.4 (tetë mijë e

dyqind e njëmbëdhjetë pikë katër) m², sipas formularit dhe planrilevimit që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Kulturës, të ndërtesave nr. 1, nr. 4, nr. 5, nr. 6, nr. 7, nr. 8, nr. 9, sipas planit të rilevimit dhe formularit bashkëlidhur këtij vendimi, që ndodhen në pasurinë e llojit “truall”, me nr. 26/144, zona kadastrale 8642.

3. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, të pasqyrojë në kartelën e pasurisë së paluajtshme 26/144, zona kadastrale 8642 (seksioni A - “të dhënat e pasurisë”), sipërfaqet e ndërtesave të përcaktuara në pikën 2, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Kulturës dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE					
PRONARI: SHTET/MINISTRIA E KULTURES			DATE: 25.04.2023		QELLI: INVENTARIZIM/REGJISTRIM
VENDNDODHJA BASHKIA: SARANDE DVASHK: SARANDE ZONA KADASTRALE: 8642 NUMRI PASURIE: 26/144, 26/139, 26/487 INDEX HARTE: SR-14-13 TE DHËNAT E PASURISË LLOJI PASURISË: TRUALL SIP PASURISË = m ² SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT = m ² NUMRI KATEVE:					
X 502128 Y 4414688 KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE X 502268 Y 4414688					
SHËNJËS - RUP: TOTALE, TRUALL, PER KALIM PRONESIE = 8211.4 m ² - RUP: TRUALL PER KALIM PRONESIE RUES E PAS 26/144 = 6466.02 m ² - RUP: TRUALL PER KALIM PRONESIE RUES E PAS 26/139 = 325.9 m ² - RUP: TRUALL PER KALIM PRONESIE RUES E PAS 26/487 = 1399.5 m ² - RUP: E GJURMES SE NDERTIMIT PER KALIM PRONESIE = 965.4 m ² OBJ.1=150m ² , OBJ.2=358.3m ² , OBJ.3=149.4m ² , OBJ.4=35m ² , OBJ.5=97m ² , OBJ.6=12.6m ² , OBJ.7=7.2m ² , OBJ.8=53.9m ² , OBJ.9=122.0m ²					
SH 1:500					
Nr	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	IDINIPT
1	VERI			26/487	
2	JUG			26/487	
3	LINDJE			26/487	
4	PERENDIM			26/487	
REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT			TEKNOLOGJIA E MATJEVE:		
EMRI (PERSONAL): RIJAN BALANI			Kode per teknologjine e matjeve: T-Teren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash;		
LICENCA: MKZ-09601, DATE 26.09.2017			PERCATTIMI KUFIRIT:		
PERSON FIZIK: RIJAN BALANI			Kode per percattimin e kufirit: P-Perfaqesues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht;		
NPT: L83823801N			PB-Perfaqesues Bashkie, HK-Harta Kadastrale;		
HENSKRIMI/VULA			SHENIME TE VECANTA:		
REALIZOI PER ASHK			PRONAR/BASHKEPRONAR/DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET		
SPECIALISTI			EMRI:		
DVASHK			HENSKRIMI:		
HENSKRIMI					
KONFIRMIMI					
PERGJEGJESORETORI: Feimi					
HENSKRIMI / VULA					
Kode per teknologjine e matjeve dhe percattimin e kufirit: T-Teren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Perfaqesues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Perfaqesues Bashkie; HK-Harta Kadastrale					



3. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETERORE (Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa te vecanta)

Institucioni Qendror: Ministria e Kulturës			Identifikoi: Orgest Feimi, Drejtor, DRTK VLORE Orgest Feimi		Digitally signed by Orgest Feimi Date: 2023.08.31 12:53:50 +02'00'	
Bashkia / Komuna: Sarandë			Supervizoi: EDLIRA CIMBI, DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKONOMIK			
Fusha e përdorimit të Pronës: Monument Kull			Aprovoi: ZERINA BRUCI, SEKRETAR I PËRGJITHSHËM			
			(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)			
			(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)			
			(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)			

A		B			C					
Nr. Rend.	Zona Kadastr. Indeksi / Hartes	Nr. Pasurisë	Emertesa e Pronës Vend ndodhja / Shtrirja Gjeografike	Komponentet perberes te Pronës	Adresa/Vend ndodhja e komponenteve perberes	Permasat e Pronës ne m ² ose m	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni/Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni/Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te vecanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	8642 J-34-5- (35-B)	26/144 26/139 26/487	Monument Kulture Kalaja e Lëkurësit Sarandë	Truall + Ndertese	Kalaja e Lëkurësit Sarandë		Monument kulture	Ministria e Kulturës	DRTK Vlorë	
	8642 J-34-5- (35-B)	26/144 26/139 26/487		Rrethimi i Kalasë	Truall Truall Truall	6486.02 325.9 1399.5	Monument kulture	Ministria e Kulturës	DRTK Vlorë	
	8642 J-34-5- (35-B)			Objekt 1	Ndërtesë	150	Monument kulture	Ministria e Kulturës	DRTK Vlorë	
	8642 J-34-5- (35-B)			Objekt 2	Ndërtesë	358.3	Monument kulture	Ministria e Kulturës	DRTK Vlorë	Keto objekte sipas Karteles dhe fragmentit te hartes kadastrale te pasurisë 26/144, zk 8642 janë ndertime pa leje

3. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETERORE (Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa te vecanta)

	8642 J-34-5- (35-B)			Objekt 3	Ndërtesë	149.4	Monument kulture	Ministria e Kulturës	DRTK Vlorë	Keto objekte sipas Karteles dhe fragmentit te hartes kadastrale te pasurisë 26/144, zk 8642 janë ndertime pa leje
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
	8642 J-34-5- (35-B)			Objekt 4	Ndërtesë	35	Monument kulture	Ministria e Kulturës	DRTK Vlorë	
	8642 J-34-5- (35-B)			Objekt 5	Ndërtesë	97	Monument kulture	Ministria e Kulturës	DRTK Vlorë	
	8643 J-34-5- (35-B)			Objekt 6	Ndërtesë	12.6	Monument kulture	Ministria e Kulturës	DRTK Vlorë	
	8644 J-34-5- (35-B)			Objekt 7	Ndërtesë	7.2	Monument kulture	Ministria e Kulturës	DRTK Vlorë	
	8643 J-34-5- (35-B)			Objekt 8	Ndërtesë	33.9	Monument kulture	Ministria e Kulturës	DRTK Vlorë	
	8644 J-34-5- (35-B)			Objekt 9	Ndërtesë	122	Monument kulture	Ministria e Kulturës	DRTK Vlorë	

Orgest
Feimi



UDHËZIM

Nr. 11, datë 24.7.2023

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN
NR. 10, DATË 26.1.2015, “PËR RREGULLAT
DHE PROCEDURAT E SHQYRTIMIT TË
ANKIMEVE ADMINISTRATIVE TË
SUBJEKTEVE MINERARE TË
LICENCUARA”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, si dhe të pikës 5, të nenit 45, pikës 5, të nenit 46, të ligjit nr. 10 304, datë 15.7.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 10, datë 26.1.2015, bëhet ndryshimi si më poshtë:

a) Pika 6, ndryshon me përmbajtje si më poshtë:

“6. Njësia e vlerësimit të ankimeve përbëhet nga 7 anëtarë, me përbërje si më poshtë:

i. Sekretari i Përgjithshëm ose një nga drejtorët e përgjithshëm të aparatit të ministrisë, kryetar;

ii. dy përfaqësues nga drejtoria përgjegjëse për fushën e minierave, anëtar;

iii. një përfaqësues nga drejtoria përgjegjëse për çështjet juridike, anëtar;

iv. një përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, anëtar;

v. një përfaqësues nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera, anëtar;

vi. një përfaqësues nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, anëtar.”.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi institucionet e përmendura në pikën 6 dhe Njësia e Vlerësimit të Ankimeve të Masave Administrative.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDESKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku**

NJOFTIM

Nr. 12983, datë 22.8.2023

**MBI HYRJEN NË FUQI TË
MARRËVESHJES NDËRKOMBËTARE**

Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi, për hapjen e pikës së përbashkët të kalimit kufitar Shën Nikolla–Pulaj, për qarkullimin rrugor ndërkombëtar dhe kryerjen e veprimtarive të përbashkëta të kontrollit kufitar, nënshkruar në Podgoricë, më 27.2.2023, ka hyrë në fuqi më 9 gusht 2023.

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
DREJTOR I PËRGJITHSHËM I
ÇËSHTJEVE POLITIKE
DHE STRATEGJIKE
Sokol Dedja**

VENDIM

Nr. 11, datë 22.8.2023

**BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË
DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH**

Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar; në kreun I, nenin 22, pika 4, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, të ndryshuar, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023, të Kryetarit të Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH”, të ndryshuar; me urdhrin nr. 56, datë 23.3.2023, “Për një ndryshim në urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023, ‘Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH’”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, me vendimin nr. 11, datë 22.8.2023, si më poshtë:

**I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:**

1. Dosja nr. 125, “Materiale operative – agjenturiale mbi zbuluesin S. P.”, 8 (tetë) fletë + 85 (tetëdhjetë e pesë) fletë. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”. Fondi Drejtoria e parë e ish Sigurimit të Shtetit, UNRRA, viti 1947, kutia 23.

2. Dosje nr. 429, “Informacion mbi shtrirjen e agjenturës në brezin kufitar”, me 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit “Sekret”. Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, dega 1, viti 1970, kutia 17.

3. Dosje nr. 445, “Përgjithësim mbi veprimtarinë armiqësore të zbulimeve të huaja kapitalisto-revizioniste nëpërmjet tregtarëve, specialistëve dhe shoferëve të huaj që vijnë në vendin tonë”, me 8 (tetë) fletë. Niveli i klasifikimit “Sekret”. Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, dega 1, viti 1973, kutia 18.

4. Dosje nr. 440/30, “Përfundime mbi veprimtarinë e zbulimeve të huaja”, me 22 (njëzet e dy) fletë, ruhet vetëm origjinal. Niveli i klasifikimit “Sekret”. Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, dega 1, viti 1972, kutia 18.

5. Dosje nr. 53, “Lista e personaliteteve politike shqiptare dhe veprimtaria e tyre para dhe gjatë viti t 1939”, me 37 (tridhjetë e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit “Sekret”. Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, UNRRA, viti 1945, kutia 21.

6. Dosje nr. 344, “Dokumente anglo-amerikane para dhe pas viti t 1944”, me 15 (pesëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”. Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, dega 1, viti 1963, kutia 16.

7. Dosje nr. 357, “Raport mbi diversionin ideologjik të zbulimeve të huaja”, me 10 (dhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”. Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, dega 1, viti 1964, kutia 16.

8. Dosje nr. 358, “Përfundime për veprimtarinë e zbulimeve të huaja gjatë viti t”, me 18 (tetëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”. Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, dega 1, viti 1964, kutia 16.

9. Dosje nr. 324, “Relacion mbi një organizatë në shërbim zbulimit anglez me në krye Q. K.”, me 2 (dy) fletë. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”. Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, dega 1, viti 1962, kutia 15.

10. Dosje nr. 305, “Relacion mbi grupet e goditura në vitet 1946-47 në dobi të zbulimit anglez”, me 5 (pesë) fletë. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”. Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, dega 1, viti 1962, kutia 15.

11. Dosje nr. 307, “Relacion mbi emigracion grek në Shqipëri”, me 5 (pesë) fletë. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”. Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, dega 1, viti 1962, kutia 15.

12. Dosje nr. 308, “Relacion mbi emigracion grek në Shqipëri”, me 14 (katërmëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”. Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, dega 1, viti 1962, kutia 15.

13. Dosje nr. 23 “Veprimtaria armiqësore e komisionit qendror jugosllav ndaj Shqipërisë”, me 4 (katër) fletë. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”. Fondi Drejtoria e parë e Sigurimit të Shtetit, dega 2, Legatat, Viti 1955, Kutia 28.

14. Dosje nr. 440/29, “Informacion mbi persona që ushtrojnë veprimtari në dobi të zbulimeve të huaja”, me 11 (njëmbëdhjetë) fletë, ruhet vetëm origjinal. Niveli i klasifikimit “Sekret”. Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, dega 1, viti 1972, kutia 18.

15. Dosje nr. 273, “Relacion mbi qendrat e zbulimit anglez e amerikan që veprojnë kundër vendit tonë nga territore si RFGJ, Greqi, etj.”, me 11 (njëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”. Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, dega 1, viti 1961, kutia 15.

16. Dosje nr. 281, “Relacion mbi përfaqësuesit e Partisë Komuniste Greke të ardhur në vendin tonë”, me 13 (trembëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”. Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, dega 1, viti 1961, kutia 15.

17. Dosje nr. 283, “Relacion mbi emigrantët grekë J. F. dhe I. K.”, me 28 (njëzet e tetë) fletë. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”. Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, dega 1, viti 1961, kutia 15.

18. Dosje nr. 284, “Historiku i zbulimit francez, relacione, raporte, etj.”, me 12 (dymbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”. Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, dega 1, viti 1961, kutia 15.

19. Dosje nr. 302, “Plani i masave operative për gjurmimin e diplomatit R.K.”, me 18 (tetëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit “Tepër



sekret”. Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, dega 1, viti 1962, kutia 15.

20. Dosje nr. 304, “Relacione e plan masash mbi zbulimet anglo-amerikane”, me 54 (pesëdhjetë e katër) fletë. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”. Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, dega 1, viti 1962, kutia 15.

21. Dosje nr. 254, “Relacion mbi veprimtarinë e zbulimit grek kundër vendit tonë, rezultatet e politikës së goditjes në vitet 1958–1959”, me 39 (tridhjetë e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”. Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, dega 1, viti 1960, kutia 14.

22. Dosje nr. 31, “Informacion dërguar Drejtorisë së I, degës IV, V, e Degës së Punëve të Brendshme të rretheve mbi agjentët e mundshëm të zbulimeve të huaja, persona për agjitacion e propagandë si dhe lidhjet e tyre të dyshimta”, me 14 (katërmëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit “Sekret”. Fondi nr. 132, dega e Sigurimit të Naftës, viti 1979, kutia 4.

23. Drejtoria e II, dosje me materiale për kartotekë, me 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit “Sekret”. Dokumentet i përkasin vitit 1991.

24. Dosje nr. 314, “Shënime mbi studimin e zbulimit turk”, me 7 (shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”. Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, dega 1, viti 1962, kutia 15.

25. Dosje nr. 271, “Raporte vjetore mbi veprimtarinë armiqësore të zbulimeve të huaja, listat emërorë dhe statistika e goditjeve të agjentëve të zbulimeve kapitaliste”, me 29 (njëzet e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”. Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, dega 1, viti 1961, kutia 15.

26. Dosje nr. 272, “Dosje fashikullore me materiale dokumentare në gjuhë shqipe dhe anglisht mbi veprimtarinë armiqësore të zbulimit anglo-amerikan SBS kundër vendit tonë”, me 77 (shtatëdhjetë e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”. Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, dega 1, viti 1961, kutia 15.

27. Dosje nr. 21 “Relacion mbi takimin e ministrit jugosllav në Tiranë me b.p. të Sigurimit “Dara”, me 4 (katër) fletë. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”. Fondi Drejtoria e parë e Sigurimit të Shtetit, dega 2, Legatat, viti 1955, kutia 28.

28. Drejtoria e Punëve të Brendshme Tiranë, dosje përpunimi nr. 63, në ngarkim të I. K., me 13

(trembëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”. Dokumentet i përkasin vitit 1978–1991.

29. Fondi Drejtoria e II, (MJ) Dosje përpunimi nr. 63 në ngarkim të I. K., me 159 (njëqind e pesëdhjetë e nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”. Dokumentet i përkasin vitet 1978–1991.

30. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 1 (1551), me pseudonimin “Shkëmbi”, në total 39 (tridhjetë e nëntë) fletë; dosja daton në vitet 1982–1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 1.

31. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 2 (1213), me pseudonimin “Komjani”, në total 48 (dyzet e tetë) fletë; dosja daton në vitet 1976–1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 1.

32. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 3 (1955), me pseudonimin “Sorkadhi”, në total 22 (njëzet e dy) fletë; dosja daton në vitin 1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 1.

33. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 4 (1831), me pseudonimin “Rezervuari”, në total 26 (njëzet e gjashtë) fletë; dosja daton në vitet 1986–1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 1.

34. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 5 (1921), me pseudonimin “Ndërgjegjja”, në total 30 (tridhjetë) fletë; dosja daton në vitet 1989–1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 1.

35. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 6 (1967), me pseudonimin “Bredhi”, në total 20 (njëzet) fletë; dosja daton në vitin 1990. Niveli i klasifikimit “Sekret”, kutia 1.

36. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 7 (1147), me pseudonimin “Mali”, në total 53 (pesëdhjetë e tre) fletë; dosja daton në vitet 1974–1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 1.

37. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 8 (1532), me pseudonimin “Muzikanti”, në total 44 (dyzet e katër) fletë; dosja daton në vitet 1989–1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 1.

38. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 9 (1771), me pseudonimin “Liçeni”, në total 29 (njëzet e nëntë)



fletë; dosja daton në vitet 1981–1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 1.

39. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 10 (1707), me pseudonimin “Lenia”, në total 39 (tridhjetë e nëntë) fletë; dosja daton në vitet 1985–1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 1.

40. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 11 (1730), me pseudonimin “Vertoqi”, në total 35 (tridhjetë e pesë) fletë; dosja daton në vitet 1986–1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 1.

41. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 12 (1706), me pseudonimin “Dushku”, në total 30 (tridhjetë) fletë; dosja daton në vitet 1985–1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 1.

42. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 13 (1899), me pseudonimin “Mekaniku”, në total 27 (njëzet e shtatë) fletë; dosja daton në vitet 1989–1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 1.

43. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 14 (1317), me pseudonimin “Pisha e Butë”, në total 32 (tridhjetë e dy) fletë; dosja daton në vitet 1978–1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 1.

44. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 15 (1733), me pseudonimin “Gramozi”, në total 28 (njëzet e tetë) fletë; dosja daton në vitet 1986–1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 1.

45. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 16 (1933), me pseudonimin “Libri”, në total 27 (njëzet e shtatë) fletë; dosja daton në vitet 1988–1990. Niveli i klasifikimit “Sekret”, kutia 1.

46. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 17 (199), me pseudonimin “Lumi i Senicës”, në total 80 (tetëdhjetë) fletë; dosja daton në vitet 1952–1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 1.

47. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 18 (1954), me pseudonimin “Leshnica”, në total 28 (njëzet e tetë) fletë; dosja daton në vitin 1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 1.

48. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 19 (1894), me pseudonimin “Lampa”, në total 25 (njëzet e pesë)

fletë; dosja daton në vitet 1989–1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 1.

49. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 20 (1910), me pseudonimin “Devolli”, në total 27 (njëzet e shtatë) fletë; dosja daton në vitet 1989–1990. Niveli i klasifikimit “Sekret”, kutia 1.

50. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 21 (1903), me pseudonimin “Ura”, në total 24 (njëzet e katër) fletë; dosja daton në vitet 1989–1990. Niveli i klasifikimit “Sekret”, kutia 1.

51. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 22 (1318), me pseudonimin “Farkëtar”, në total 32 (tridhjetë e dy) fletë; dosja daton në vitet 1978–1990. Niveli i klasifikimit “Sekret”, kutia 1.

52. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 23 (982), me pseudonimin “Shiroka”, në total 50 (pesëdhjetë) fletë; dosja daton në vitet 1972–1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 1.

53. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 24 (1732), me pseudonimin “Besa”, në total 41 (dyzet e një) fletë; dosja daton në vitet 1963–1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 1.

54. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 25 (1065), me pseudonimin “Sorkadhja”, në total 36 (tridhjetë e gjashtë) fletë; dosja daton në vitet 1974–1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 1.

55. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale nr. 26 (1880), me pseudonimin “Drita”, në total 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë; dosja daton në vitin 1988. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 2.

56. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 27 (1777), me pseudonimin “Frashëri”, në total 26 (njëzet e gjashtë) fletë; dosja daton në vitet 1986–1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 2.

57. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 28 (1973), me pseudonimin “Lisi”, në total 17 (shtatëmbëdhjetë) fletë; dosja daton në vitin 1990. Niveli i klasifikimit “Sekret”, kutia 2.

58. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 29 (1717), me pseudonimin “Koshnica”, në total 32 (tridhjetë e dy)



fletë; dosja daton në vitet 1972–1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 2.

59. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 30 (1129), me pseudonimin “Tuneli”, në total 28 (njëzet e tetë) fletë; dosja daton në vitet 1975–1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 2.

60. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 31 (1616), me pseudonimin “Dajti”, në total 29 (njëzet e nëntë) fletë; dosja daton në vitet 1983–1988. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 2.

61. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 32 (1534), me pseudonimin “Riviera”, në total 31 (tridhjetë e një) fletë; dosja daton në vitet 1981–1990. Niveli i klasifikimit “Sekret”, kutia 2.

62. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 33 (1575), me pseudonimin “Manushaqja”, në total 26 (njëzet e gjashtë) fletë; dosja daton në vitet 1982–1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 2.

63. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 34 (1763), me pseudonimin “Furtuna”, në total 26 (njëzet e gjashtë) fletë; dosja daton në vitet 1986–1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 2.

64. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale nr. 35 (1195), me pseudonimin “Sportisti”, në total 22 (njëzet e dy) fletë; dosja daton në vitet 1986–1989. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 2.

65. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 36 (1527), me pseudonimin “Besniku”, në total 25 (njëzet e pesë) fletë; dosja daton në vitet 1981–1990. Niveli i klasifikimit “Sekret”, kutia 2.

66. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 37 (1909), me pseudonimin “Shkëmbi”, në total 23 (njëzet e tre) fletë; dosja daton në vitet 1989–1990. Niveli i klasifikimit “Sekret”, kutia 2.

67. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 38 (1699), me pseudonimin “Lisesi”, në total 23 (njëzet e tre) fletë; dosja daton në vitet 1985–1989. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 2.

68. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 39 (1827), me pseudonimin “Pisha”, në total 20 (njëzet) fletë; dosja

daton në vitin 1988. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 2.

69. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 40 (992), me pseudonimin “Marangozi”, në total 29 (njëzet e nëntë) fletë; dosja daton në vitet 1973–1988. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 2.

70. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale nr. 41 (1633), me pseudonimin “Pelikani”, në total 13 (trembëdhjetë) fletë; dosja daton në vitin 1984. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 2.

71. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale nr. 42 (1799), me pseudonimin “Pompa”, në total 14 (katërmëdhjetë) fletë; dosja daton në vitin 1987. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 2.

72. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale nr. 43 (1785), me pseudonimin “Teli”, në total 14 (katërmëdhjetë) fletë; dosja daton në vitet 1986–1987. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 2.

73. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 44 (1136), me pseudonimin “Libri”, në total 21 (njëzet e një) fletë; dosja daton në vitet 1975–1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 2.

74. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 45 (1572), me pseudonimin “Sogora”, në total 26 (njëzet e gjashtë) fletë; dosja daton në vitet 1982–1989. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 2.

75. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 46 (1581), me pseudonimin “Çobani i Vjetër”, në total 25 (njëzet e pesë) fletë; dosja daton në vitet 1982–1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 2.

76. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 47 (1083), me pseudonimin “Strugu”, në total 29 (njëzet e nëntë) fletë; dosja daton në vitet 1974–1989. Niveli i klasifikimit “Sekret”, kutia 2.

77. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje pune nr. 48 (1414), me pseudonimin “Kalaja”, në total 10 (dhjetë) fletë; dosja daton në vitet 1984–1988. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 3.

78. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 49 (1914), me pseudonimin “Drini”, në total 18 (tetëmbëdhjetë)



fletë; dosja daton në vitet 1989–1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 3.

79. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 50 (1676), me pseudonimin “Trëndafil”, në total 27 (njëzet e shtatë) fletë; dosja daton në vitet 1982–1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 3.

80. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 51 (1590), me pseudonimin “Patrioti”, në total 27 (njëzet e shtatë) fletë; dosja daton në vitet 1983–1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 3.

81. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 52 (272), me pseudonimin “Trëndafil” në total 35 (tridhjetë e pesë) fletë; dosja daton në vitet 1963–1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 3.

82. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 53 (1442), me pseudonimin “Korabi”, në total 30 (tridhjetë) fletë; dosja daton në vitet 1980–1989. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 3.

83. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 54 (1949), me pseudonimin “Mali”, në total 20 (njëzet) fletë; dosja daton në vitin 1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 3.

84. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 55 (1865), me pseudonimin “Gorica”, në total 23 (njëzet e tre) fletë; dosja daton në vitet 1989–1989. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 3.

85. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 56 (1395), me pseudonimin “Vëzhguesi”, në total 29 (njëzet e nëntë) fletë; dosja daton në vitet 1979–1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 3.

86. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale nr. 57 (1913), me pseudonimin “Pisha”, në total 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë; dosja daton në vitin 1989. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 3.

87. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 58 (1991), me pseudonimin “Kufitari”, në total 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë; dosja daton në vitet 2.3.1991–6.3.1991. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 3.

88. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 59 (1299), me

pseudonimin “Debatiku”, në total 27 (njëzet e shtatë) fletë; dosja daton në vitet 1978–1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 3.

89. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 60 (1094), me pseudonimin “Plumbi”, në total 32 (tridhjetë e dy) fletë; dosja daton në vitet 1974–1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 3.

90. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 61 (1944), me pseudonimin “Futbollisti”, në total 18 (tetëmbëdhjetë) fletë; dosja daton në vitin 1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 3.

91. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale nr. 62 (1632), me pseudonimin “Qershia”, në total 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë; dosja daton në vitet 1984–1989. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 3.

92. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale nr. 63 (1741), me pseudonimin “Dinamo”, në total 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë; dosja daton në vitet 1986–1989. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 3.

93. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 64 (1953), me pseudonimin “Revista”, në total 20 (njëzet) fletë; dosja daton në vitin 1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 3.

94. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 65 (1794), me pseudonimin “Devolli”, në total 28 (njëzet e tetë) fletë; dosja daton në vitet 1985–1990. Niveli i klasifikimit “Sekret”, kutia 3.

95. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 66 (1891), me pseudonimin “Panja”, në total 29 (njëzet e nëntë) fletë; dosja daton në vitet 1974–1990. Niveli i klasifikimit “Sekret”, kutia 3.

96. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 67 (1550), me pseudonimin “Vigilenti”, në total 24 (njëzet e katër) fletë; dosja daton në vitet 1982–1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 3.

97. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje personale dhe pune nr. 68 (1519), me pseudonimin “Profesori”, në total 29 (njëzet e nëntë) fletë; dosja daton në vitet 1981–1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 3.

98. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh. Dosje personale dhe pune nr. 69 (1729), me



pseudonimin “Adriatiku”, në total 37 (tridhjetë e shtatë) fletë; dosja daton në vitet 1986–1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 4.

99. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh. Dosje personale dhe pune nr. 70 (1498), me pseudonimin “Mimoza”, në total 30 (tridhjetë) fletë; dosja daton në vitet 1981–1989. Niveli i klasifikimit “Sekret”, kutia 4.

100. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh. Dosje personale dhe pune nr. 71 (1018), me pseudonimin “Lumi”, në total 34 (tridhjetë e katër) fletë; dosja daton në vitet 1973–1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 4.

101. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh. Dosje personale dhe pune nr. 72 (1475), me pseudonimin “Besniku”, në total 34 (tridhjetë e katër) fletë; dosja daton në vitet 1980–1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 4.

102. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh. Dosje personale dhe pune nr. 73 (1971), me pseudonimin “Mallagjeçi”, në total 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë; dosja daton në vitin 1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 4.

103. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh. Dosje personale dhe pune nr. 74 (1593), me pseudonimin “Tomorri”, në total 51 (pesëdhjetë e një) fletë; dosja daton në vitet 1983–1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 4.

104. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh. Dosje personale dhe pune nr. 75 (1412), me pseudonimin “Telegrafi”, në total 42 (dyzet e dy) fletë; dosja daton në vitet 1979–1990. Niveli i klasifikimit “Sekret”, kutia 4.

105. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh. Dosje personale dhe pune nr. 76 (1688), me pseudonimin “Tekniku”, në total 31 (tridhjetë e një) fletë; dosja daton në vitet 1985–1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 4.

106. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh. Dosje personale dhe pune nr. 77 (1547), me pseudonimin “Diagnoza”, në total 29 (njëzet e nëntë) fletë; dosja daton në vitet 1982–1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 4.

107. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh. Dosje personale dhe pune nr. 78 (1242), me pseudonimin “Murratori”, në total 44 (dyzet e katër) fletë; dosja daton në vitet 1977–1990. Niveli i klasifikimit “Sekret”, kutia 4.

108. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh. Dosje personale dhe pune nr. 79 (1473),

me pseudonimin “Vëzhguesi”, në total 36 (tridhjetë e gjashtë) fletë; dosja daton në vitet 1980–1990. Niveli i klasifikimit “Sekret”, kutia 4.

109. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh. Dosje personale dhe pune nr. 80 (1895), me pseudonimin “Bibloteka”, në total 18 (tetëmbëdhjetë) fletë; dosja daton në vitet 1989–1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 4.

110. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh. Dosje personale dhe pune nr. 81 (1320), me pseudonimin “Kaprolli”, në total 34 (tridhjetë e katër) fletë; dosja daton në vitet 1978–1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 4.

111. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh. Dosje personale dhe pune nr. 82 (1392), me pseudonimin “Marangozi”, në total 29 (njëzet e nëntë) fletë; dosja daton në vitet 1979–1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 4.

112. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh. Dosje personale dhe pune nr. 83 (1535), me pseudonimin “Ndergjegja”, në total 26 (njëzet e gjashtë) fletë; dosja daton në vitet 1981–1989. Niveli i klasifikimit “Sekret”, kutia 4.

113. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh. Dosje personale dhe pune nr. 84 (1643), me pseudonimin “Besniku”, në total 26 (njëzet e gjashtë) fletë; dosja daton në vitet 1984–1989. Niveli i klasifikimit “Sekret”, kutia 4.

114. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh. Dosje personale dhe pune nr. 85 (1683), me pseudonimin “Trimi”, në total 18 (tetëmbëdhjetë) fletë; dosja daton në vitet 1985–1989. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 4.

115. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh. Dosje pune nr. 86 (1751), me pseudonimin “Ylli”, në total 20 (njëzet) fletë; dosja daton në vitet 1986–1987. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 4.

116. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh. Dosje personale dhe pune nr. 87 (1868), me pseudonimin “Pëllumbi”, në total 27 (njëzet e shtatë) fletë; dosja daton në vitet 1987–1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 4.

117. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje agenturore nr. 189, me pseudonimin “Merimanga”, në total 365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) fletë; dosja daton në vitin 1986. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 9.

118. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje përpunimi nr. 1049, me 2 vëllime, në



total 191 (njëqind e nëntëdhjetë e një) fletë; dosja daton në vitin 1986–1989. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 9.

119. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje formulare nr. 1001, në total 43 (dyzet e tre) fletë; dosja daton në vitin 1978–1987. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 9.

120. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje formulare nr. 1048, me 2 vëllime, në total 90 (nëntëdhjetë) fletë; dosja daton në vitin 1986–1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 9.

121. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje formulare nr. 971, me 2 vëllime, në total 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë) fletë; dosja daton në vitin 1986–1987. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 9.

122. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje formulare nr. 733, në total 39 (tridhjetë e nëntë) fletë; dosja daton në vitin 1980–1989. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 9.

123. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje formulare nr. 512, në total 89 (tetëdhjetë e nëntë) fletë; dosja daton në vitin 1961–1988. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 9.

124. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje formulare nr. 744, në total 78 (shtatëdhjetë e tetë) fletë; dosja daton në vitin 1955–1989. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 9.

125. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje formulare nr. 871, në total 134 (njëqind e tridhjetë e katër) fletë; dosja daton në vitin 1970–1990. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 9.

126. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje formulare nr. 957, me 2 vëllime, në total 154 (njëqind e pesëdhjetë e katër) fletë; dosja daton në vitin 1986–1987. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 9.

127. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje drejtimi nr. 60, “Për vjedhjet e pasurisë së shtetasve dhe mashtrimet”, me 2 vëllime, në total 28 (njëzet e tetë) fletë; dosja daton në vitin 1973–1988. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 8.

128. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje drejtimi nr. 59, “Për vjedhjet me thyerje nga jashtë të pasurisë socialiste”, me 2 vëllime, në total 137 (njëqind e tridhjetë e shtatë)

fletë; dosja daton në vitin 1973–1988. Niveli i klasifikimit “Sekret”, kutia 8.

129. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje drejtimi nr. 70, “Për lëndët narkotike”, me 2 vëllime, në total 17 (shtatëmbëdhjetë) fletë; dosja daton në vitin 1978–1987. Niveli i klasifikimit “Sekret”, kutia 8.

130. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje drejtimi nr. 44, “Për krime të tjera”, me 2 vëllime, në total 22 (njëzet e dy) fletë; dosja daton në vitin 1973. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 8.

131. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje drejtimi nr. 41, “Për krimet kundër personit”, me 2 vëllime, në total 46 (dyzet e gjashtë) fletë; dosja daton në vitin 1973–1985. Niveli i klasifikimit “Sekret”, kutia 8.

132. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje drejtimi nr. 40, “Për veprat shoqërisht të rrezikshme të kryer nga persona të mitur”, me 2 vëllime, në total 26 (njëzet e gjashtë) fletë; dosja daton në vitin 1973–1985. Niveli i klasifikimit “Sekret”, kutia 8.

133. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje drejtimi komunale nr. 84, me 2 vëllime, në total 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë; dosja daton në vitin 1987. Niveli i klasifikimit “Sekret”, kutia 8.

134. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje drejtimi tregtisë nr. 85, me 2 vëllime, në total 34 (tridhjetë e katër) fletë; dosja daton në vitin 1987–1989. Niveli i klasifikimit “Sekret”, kutia 8.

135. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje drejtimi transport/komunikacion nr. 87, me 2 vëllime, në total 14 (katërmëdhjetë) fletë; dosja daton në vitin 1987. Niveli i klasifikimit “Tepër sekret”, kutia 8.

136. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje drejtimi financë bankë nr. 88, me 2 vëllime, në total 17 (shtatëmbëdhjetë) fletë; dosja daton në vitin 1987. Niveli i klasifikimit “Sekret”, kutia 8.

137. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, dosje e sektorëve ekonomikë për drejtimet e kulturë-arsim-shëndetësi nr. 10, me 2 vëllime, në total 49 (dyzet e nëntë) fletë; dosja daton në vitin 1981–1986. Niveli i klasifikimit “Sekret”, kutia 8.

138. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Gramsh, Libër i evidencës agjenturalo-operative e



punëtorit operativ Haxhi. Kanani, nr. 136, datë 24.2.1984, me 265 (dyqind e gjashtëdhjetë e pesë) fletë; Niveli i klasifikimit “Sekret”.

139. Fondi nr. IV, dosje nr. 64, “Disa komente të diplomatëve të vendeve revizioniste për vizitën e N.T.’, me 6 (gjashtë) fletë. Dosja daton në vitin 1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

140. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Vlorë, dosje përpunimi nr. 4294, viti 1975–1986, me dy vëllime, me 97 (nëntëdhjetë e shtatë) dhe 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

141. Fondi Kosova, dosje përpunimi nr. 9214, me 4 volume, me 912 (nëntëqind e dymbëdhjetë) fletë në total; dosja daton në vitet 1972–1977. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

1. Arsyeja e deklasifikimit të dokumenteve të sipërcituara është:

- Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nenin 22, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, si dhe në vendimin e Autoritetit nr. 31, datë 24.1.2023, pika 1 e dispozitivit.

2. Ngarkohet Sekretari i KDZH-së të bëjë evidentimet përkatëse në regjistër, të vendosë vulën përkatëse mbi dokumentet e deklasifikuara dhe të hartojë bibliografinë e informacionit të deklasifikuar.

3. Kopja e bibliografisë së informacionit të deklasifikuar t’i dërgohet zyrtarisht Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar.

4. Të bëhet publikimi i dokumenteve të deklasifikuara në faqen zyrtare të internetit të AIDSSH-së dhe në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR I KDZH-së
Gentiana Sula

VENDIM

Nr. 12, datë 22.8.2023

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH

Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës

Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar; në kreun I, neni 22, pika 4, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, të ndryshuar; në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023, të Kryetarit të Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH”, të ndryshuar; me urdhrin nr. 56, datë 23.3.2023 “Për një ndryshim në urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023, ‘Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar ‘Sekret shtetëror’ në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, me vendimin nr. 12, datë 22.8.2023, si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Fondi të Arratisur, fashikull nr. 2272, me 51 (pesëdhjetë e një) fletë. Dosja daton në vitet 1953–1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

2. Fondi Dega e Punëve të Brendshme Tiranë, dosje objekti nr. 137, muzeu “Enver Hoxha”, me 2 volume, në total me 43 (dyzet e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1986–1989. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Sekret”.

3. Fondi i Veçantë, dosje pa nr., “Valbona”, me 3 volume në total me 503 (pesëqind e tre) fletë. Dosja daton në vitet 1969–1975. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër sekret”.

1. Arsyeja e deklasifikimit të dokumenteve të sipërcituara është:

- Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nenin 22, të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”, si dhe në vendimin e Autoritetit nr. 31, datë 24.1.2023, pika 1 e dispozitivit.

2. Ngarkohet Sekretari i KDZH-së të bëjë evidentimet përkatëse në regjistër, të vendosë vulën përkatëse mbi dokumentet e deklasifikuara dhe të hartojë bibliografinë e informacionit të deklasifikuar.



3. Kopja e bibliografisë së informacionit të deklasifikuar t'i dërgohet zyrtarisht Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar.

4. Të bëhet publikimi i dokumenteve të deklasifikuara në faqen zyrtare të internetit të AIDSSH-së dhe në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR I KDZH-së
Gentiana Sula

VENDIM
Nr. 228, datë 17.7.2023

**MBI PËRCAKTIMIN E SHOQËRISË
“BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË
ELEKTRIKE ALPEX” SHA SI
OPERATORI I EMËRUAR I TREGUT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE (NEMO)**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 7, pika 2 dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; të nenit 3, pikat 3 dhe 7, të “Rregullores së kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO)”, si dhe rolet e përgjegjësitë e NEMO-s dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë në tregun e bashkuar, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 40, datë 6.3.2020; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.7.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1395/8 prot., datë 14.7.2023, të Grupit të Punës, “Mbi përcaktimin e shoqërisë ‘Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX’ sh.a., si Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO)”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1395 prot., datë 10.5.2023, paraqiti aplikimin për t’u përcaktuar si Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) dhe me shkresat e protokolluara me nr. 1395/1 prot., datë 10.5.2023 dhe nr. 1395/2 prot., datë 2.6.2023, depozitoi dokumentacion shtesë të këtij aplikimi.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 200, datë 23.6.2023, vendosi të fillojë procedurën për

përcaktimin e shoqërisë “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX” sh.a., si Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO)”.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, u bë njoftimi në median e shkruar, i cili u botua përkatësisht në datat 28.6.2023 dhe 29.6.2023, dhe në përfundim të afatit 10-ditor të përcaktuar në këtë njoftim, nuk rezultoi të ketë ndonjë koment apo opinion nga palë të treta.

- Në lidhje me vendimin nr. 200/2023, ERE, me shkresën nr. 1395/5 prot., datë 4.7.2023, njoftoi Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Sekretariatit e Komuniteti të Energjisë, Autoritetin e Konkurrencës (AK), Zyrën e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës (ZRRE), Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., Shoqatën Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë (AAES), Shoqatën e Investitorëve të Huaj (FIAA) dhe Shoqatën Shqiptare të Energjisë së Rinovueshme (AREA).

- Ndërsa me shkresën nr. 1395/6 prot., datë 5.7.2023, njoftoi aplikuesin, shoqërinë “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX” sh.a., në lidhje me dokumentacionin që mbetet ende për t’u plotësuar nga ky aplikim.

- Në përgjigje, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1397/7 prot., datë 14.7.2023, aplikuesi depozitoi dokumentacion plotësues të këtij aplikimi.

- Në zbatim të përcaktimeve të nenit 3, pikës 2, të “Rregullores së kërkesave dhe procedura për përcaktimin e Operatorit të emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), si dhe rolet e përgjegjësitë e NEMO-s dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë në tregun e bashkuar”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 40, datë 6.3.2020, për t’u përcaktuar si NEMO aplikuesi ka plotësuar shtojcën 1.a., për të vërtetuar përmbushjen e kriterëve të përmendura në nenin 4 të kësaj rregulloreje, dhe ka paraqitur dokumentet e listuara në shtojcën 1.b.

- Për gjithë sa më sipër, vlerësohet që shoqëria “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX” sh.a. të përcaktohet Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO).

- Për sa bërë me dije nga shoqëria, se programi ekonomik i ndryshuar për vitin 2023 do të përcillet për miratim pranë organeve drejtuese të ALPEX sh.a., vlerësohet që t’i lihet kusht asaj që të depozitojë në ERE këtë program të miratuar brenda 2 (dy) muajve.



- Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) është subjekt ligjor i përcaktuar nga Enti Rregullator i Energjisë për të kryer detyrat që kanë lidhje me bashkimin e tregut të ditës në avancë dhe të tregut brenda të njëjtës ditë, sipas kësaj rregulloreje. Monopoli ligjor në vend është caktimi i vetëm një Operatori të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike për sigurimin e shërbimeve të tregtimit të ditës në avancë dhe/ose tregtimin brenda ditës.

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 3, pikës 3, të rregullores, vendimi i ERE-s bazuar në legjislacionin në fuqi përcakton dhe natyrën monopol të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike.

- Në zbatim të përcaktimeve të nenit 3, pikës 4, të rregullores, përcaktimi i Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) mbetet i vlefshëm deri në përfshirjen e rregullores së Alokimit të Kapaciteteve dhe Menaxhimit të Kongjestioneve në legjislacionin e vendit, sipas të cilës përcaktimi i NEMO-s duhet të konfirmohet bazuar në rregulloren e Alokimit të Kapaciteteve dhe Menaxhimit të Kongjestioneve (CACM Regulation).

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të përcaktojë shoqërinë “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX” sh.a. si Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO).

2. Brenda 2 (dy) muajve, shoqëria Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a. duhet të depozitojë në ERE programin ekonomik të vitit 2023, të ndryshuar, të miratuar nga organet drejtuese të saj.

3. Brenda 2 (dy) muajve, shoqëria Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a. të dokumentojë në ERE informacion mbi arsyet e ndryshimit të organigramës, duke shpjeguar detyrat funksionale të personelit.

4. Përcaktimi i NEMO-s, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbetet i vlefshëm deri në përfshirjen e Rregullores së Alokimit të Kapaciteteve dhe Menaxhimit të Kongjestioneve në legjislacionin e vendit, sipas të cilës përcaktimi i NEMO-s duhet të konfirmohet bazuar në Rregulloren e Alokimit të Kapaciteteve dhe Menaxhimit të Kongjestioneve (CACM Regulation).

5. Grupi i Punës të njoftojë aplikuesin, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Zyrën e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës, si dhe Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTAR I BORDIT
Erjola Sadushi

VENDIM Nr. 240, datë 3.8.2023

MBI PEZULLIMIN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-S, NË LIDHJE ME KËRKESËN E SHOQËRISË “TEODORI 2003” SHPK, PËR TRANSFERIMIN E PJESSHËM TË LICENCËS PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE, PËR HEC ZALLI I BULQIZËS, TE SHOQËRIA “KONCESIONARE TËRNOVË ZALL BULQIZË” SHPK

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.8.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1202/40 prot., datë 2.8.2023, të drejtorive teknike të ERE-s, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Teodori 2003’ sh.p.k., për transferimin e pjesshëm të licencës për prodhimin e energjisë elektrike, vetëm për HEC



“Zalli i Bulqizës”, te shoqëria “Koncesionare Tërnovë Zall Bulqizë” sh.p.k.”,

konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1202 prot., datë 6.4.2023, shoqëria “Teodori 2003” paraqiti kërkesën për transferimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike, nga shoqëria “Teodori 2003” sh.p.k. te shoqëria “Koncesionare Tërnovë Zall Bulqizë” sh.p.k.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 161, datë 9.5.2023, vendosi të fillojë procedurën për transferimin e pjesshëm dhe modifikimin e pjesshëm të licencës për prodhimin e energjisë elektrike nr. 87, seria PV09K, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 83, datë 4.11.2009, nga shoqëria “Teodori 2003” sh.p.k. te shoqëria “Koncesionare Tërnovë Zall Bulqizë” sh.p.k., vetëm për HEC “Zalli i Bulqizës”, me kapacitet të instaluar 5.350 mw.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 11.5.2023 dhe 12.5.2023). Ky njoftim u botua dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Brenda afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga palë të treta, janë paraqitur në ERE objeksione ndaj këtij vendimi, nga z. L.L., shoqëria “Albania Hydro Investments Holding” sh.p.k., Banka “OTP Albania Bank” sh.a. dhe znj. Sh. N.

- Me shkresën nr. 1202/36 prot., datë 21.7.2023, ERE njoftoi për vendimin e mësipërm përkatësisht z. L.L. (administrator i shoqërisë “Teodori 2003” sh.p.k.), shoqërinë “Albania Hydro Investments Holding” sh.p.k., znj. Sh. N. (ortak i shoqërisë “Teodori 2003”, Bankën “OTP Albania” sh.a., shoqërinë “Teodori” sh.p.k., shoqërinë “Koncesionare Tërnovë Zall Bulqizë” sh.p.k., duke i kërkuar të depozitojnë në ERE dokumentacionin përkatës mbështetës mbi pretendimet e tyre të paraqitura në seancë dhe pretendimet përfundimtare, në lidhje me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 161/2023. Shkresa e mësipërme iu dërgua për dijeni dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE).

- Me shkresën nr. 1202/37 prot., datë 21.7.2023, ERE iu drejtua shoqërisë “Teodori 2003” sh.p.k., duke i njoftuar vendimin e Bordit nr. 223/2023, ku i kërkoj të depozitojë me shkrim të gjitha sqarimet, në lidhje me objeksionet e paraqitura për vendimin e Bordit nr. 161/2023 dhe po ashtu i solli në

vëmendje se, referuar aplikimit të saj për transferimin dhe modifikimin e pjesshëm të licencës, duhet të depozitohet në ERE dhe miratimi apo qëndrimi i MIE-s, në lidhje me transferimin e koncesionit dhe njohjen e së drejtës së shoqërisë “Koncesionare Tërnovë Zall Bulqizë” sh.p.k., për të ndërtuar dhe operuar HEC “Zalli i Bulqizës”, bazuar në përcaktimet e nenit 17, pika 2, germa “P”, të rregullores.

- Rezulton se ka depozituar pretendimet përfundimtare Banka “OTP Albania” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1202/39 prot., datë 31.7.2023.

- Me shkresën e nënshkruar nga shoqëritë “Teodori 2003” sh.p.k., “Teodori” sh.p.k., “Koncesionare Tërnovë Zall Bulqizë” sh.p.k., të protokolluar në ERE me nr. 1202/38 prot., datë 24.7.2023, janë depozituar sqarimet për secilin nga pretendimet e ngritura nga palët. Gjithashtu është depozituar dhe vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë “Koncesionare Tërnovë Zall Bulqizë” sh.p.k., të datës 30.6.2023, ku është vendosur ndryshimi i emrit të kësaj shoqërie nga “Koncesionare Tërnovë Zall Bulqizë” sh.p.k. në “Koncesionare Zall Bulqizë” sh.p.k., si dhe i objektit të veprimtarisë së saj, si vijon:

“Ndërtim dhe shfrytëzim i hidrocentralit Zall i Bulqizës sipas VKM-së nr. 556, datë 1.8.2003.

- Prodhim dhe shitje energji elektrike brenda dhe jashtë vendit, privatëve dhe shtetërorëve, sipas VKM-së nr. 556, datë 1.8.2003, për HEC Zall i Bulqizës.

- Transmetim energjie elektrike brenda vendit dhe jashtë vendit, sipas VKM-së nr. 556, datë 1.8.2003, për HEC Zall i Bulqizës.”.

- Po ashtu, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1202/38 prot., datë 24.7.2023, bëhet me dije se shoqëria është në pritje të vendimit që do të marrë MIE në cilësinë e organit shtetëror të autorizuar.

- Në lidhje me miratimin e MIE-s, në seancën dëgjimore të mbajtur në ERE në datën 3.7.2023, nga përfaqësuesit e këtij institucioni është deklaruar se procedura për transferimin e koncesionit është në vlerësim e sipër dhe se do të shqyrtohet në tërësi përpara se të merret një vendim përfundimtar, si dhe u evidentua fakti se kontrata e koncesionit ka detyrime, për mospërmbushjen e të cilave ka penalitete e si e tillë është duke u shqyrtuar me interes nga MIE.



- Në referencë të procedurës së nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 161/2023, qëndrimi apo vendimi i organit shtetëror të autorizuar (MIE-s) është thelbësor dhe parakusht për vendimarrjen përfundimtare të ERE-s, në lidhje me transferimin e pjesshëm dhe modifikimin e pjesshëm të licencës për prodhimin e energjisë elektrike, të shoqërisë “Teodori 2003” sh.p.k.

- Në mbështetje të pikës 1, të nenit 66, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, duke qenë se miratimi për transferimin e koncesionit dhe të drejtës së ndërtimit dhe operimit të HEC “Zalli i Bulqizës” është kompetencë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, dhe duke marrë në konsideratë faktin se ky organ ka deklaruar se është në shqyrtim e sipër kjo procedurë, vlerësohet të pezullohet vendimarrja e Bordit të ERE-s, në lidhje me transferimin e pjesshëm dhe modifikimin e pjesshëm të licencës për prodhimin e energjisë elektrike, vetëm për HEC “Zalli i Bulqizës”, nga shoqëria “Teodori 2003” sh.p.k. të shoqëria “Koncesionare Tërnovë Zall Bulqizë” sh.p.k. deri në depozitimin e qëndrimit/miratimit të MIE-s.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pezullojë vendimarrjen e Bordit të ERE-s, në lidhje me transferimin e pjesshëm dhe modifikimin e pjesshëm të licencës për prodhimin e energjisë elektrike, vetëm për HEC “Zalli i Bulqizës”, nga shoqëria “Teodori 2003” sh.p.k. të shoqëria “Koncesionare Tërnovë Zall Bulqizë” sh.p.k. deri në depozitimin e qëndrimit/miratimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Teodori 2003” sh.p.k., shoqërinë “Teodori” sh.p.k., shoqërinë “Koncesionare Zall Bulqizë” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, z. L. L., znj. Sh. N., shoqërinë “Albania Hydro Investment Holding” sh.p.k. dhe bankën “OTP Albania Bank” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të

ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTAR I BORDIT
Erjola Sadushi

VENDIM Nr. 241, datë 3.8.2023

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “JOINT VENTURE 2B 1979 DHE 2T” SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 10, pika 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.8.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1964/3 prot., datë 2.8.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 mw”, konstatoi se:

- Shoqëria “Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1964 prot., datë 25.7.2023, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në zonën Grykë, Bashkia Fier, qarku Fier.



- ERE, me *email*-in e datës 31.7.2023, ka kërkuar nga shoqëria që të depozitojë kontratën përkatëse të nënshkruar me MIE-n, në vijim të miratimit të marrë prej saj dhe/ose aktin në të cilin MIE njeh shoqërinë “Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” sh.p.k. si shoqëria që do të operojë centralin fotovoltaiik.

- Me *email*-in e protokolluar në ERE me nr. 1964/2 prot., datë 1.8.2023, aplikuesi ka depozituar dokumentacion plotësues, nga i cili konstatohet se në vijim të marrjes së miratimit për ndërtim të dhënë nga MIE me nr. 7234/2 prot., datë 22.11.2022, Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive, “2T” dhe “2B 1979” sh.p.k. ka nënshkruar me MIE-n kontratën nr. 340 rep., nr. 1429 kol., datë 19.5.2023, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaiike, me kapacitet prodhues 2 mw, dhe veprave ndihmëse, në zonën Grykë, Bashkia Fier, qarku Fier, nga Bashkimi i Përkohshëm i shoqërive ‘2T’ sh.p.k. dhe ‘2B 1979’ sh.p.k.”.

- Nga dokumentet e depozituara në ERE nga shoqëria “Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” sh.p.k., me *email*-in e datës 1.8.2023, konstatohet se dy shoqëritë e Bashkimit të Përkohshëm kanë rënë dakord për të krijuar shoqërinë “Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” sh.p.k., me qëllim ndërtimin e impiantit të ri gjenerues për prodhimin e energjisë elektrike (gjë që përbën dhe objektin e vetëm të veprimtarisë së saj, referuar ekstraktit historik të regjistrit tregtar të QKB-së) dhe në asnjë nga dokumentet e këtij aplikimi nuk rezulton që kësaj shoqërie t’i njihet e drejta për të operuar këtë central.

- Në zbatim të përcaktimeve të nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, ERE lëshon licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, ndërkohë që nga vlerësimi i dokumentacionit të depozituar nga aplikuesi me *email*-in e datës 1.8.2023, konstatohet se shoqërisë “Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” sh.p.k. i njihet e drejta e ndërtimit dhe jo e operimit të centralit fotovoltaiik, në vijim të marrjes së miratimit nga MIE për ndërtimin tij, me nr. 7234/2 prot., datë 22.11.2022.

- Në këto rrethana dhe në kuadër të mosplotësimit nga aplikuesi të dokumentacionit thelbësor sipas kërkesave të rregullores, vlerësohet mosfillimi i procedurës për këtë aplikim.

- Në mbështetje të parashikimeve të nenit 10, pika 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për

dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nëse aplikuesi, brenda 1 (një) muaji nga marrja dijeni e vendimit për mosfillimin e procedurës, paraqet dokumentacionin thelbësor të konstatuar të munguar, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mosfillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

2. Nëse aplikuesi paraqet një aplikim të ri, brenda 1 (një) muaji nga marrja dijeni e vendimit të Bordit të ERE-s për mosfillimin e procedurës, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa e aplikimit do të konsiderohen të vlefshme edhe për aplikimin e ri.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Joint Venture 2 B 1979 dhe 2 T” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTAR I BORDIT
Erjola Sadushi



VENDIM

Nr. 242, datë 3.8.2023

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “NOVA
SOLAR SYSTEM” SHPK NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA
CENTRALI FOTOVOLTAÏK ME
KAPACITET TË INSTALUAR 50 mw**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a”, 38, pika 1, germa “a” dhe 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, 13 dhe 14, pika 9, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.8.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1319/14 prot., datë 2.8.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë “Nova Solar System” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 50 mw”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Nova Solar System” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1319 prot., datë 26.4.2023, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 50 mw.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 159, datë 5.5.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Nova Solar System” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 50 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3358, fshatin Sheq Marinas, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 6.5.2023 dhe 8.5.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data

4.6.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ky njoftim u botua dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 1319/5 prot., datë 18.5.2023, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe zhvillimin e një seance dëgjimore për plotësimin e dokumentacionit të konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht. Shoqëria depozitoi dokumentacion plotësues të aplikimit, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1319/6 prot., datë 30.5.2023, pas shqyrtimit të të cilit u konstatua se mbetej ende dokumentacion i pa plotësuar në këtë aplikim, i cili iu evidentua shoqërisë me shkresën nr. 1319/7 prot., datë 13.6.2023.

- Shoqëria depozitoi dokumentacionin plotësues me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1319/8 prot., datë 29.6.2023.

- Për shkak të kohës së pamjaftueshme për të shqyrtuar dokumentacionin plotësues të depozituar nga shoqëria, në kuadër të këtij aplikimi, ERE, me vendimin e Bordit nr. 220, datë 4.7.2023, vendosi të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit mbi aplikimin e shoqërisë “Nova Solar System” sh.p.k., për t’u licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik.

- Në vijim, ERE iu drejtua shoqërisë me *email-in* e protokolluar me nr. 1319/10 prot., datë 21.7.2023, ku i njoftoi vendimin nr. 220/2023 dhe i evidentoi dokumentacionin që nevojitet të plotësohet ende nga ky aplikim.

- Shoqëria, brenda afatit, me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1319/11 prot., datë 1.8.2023 dhe nr. 1319/13 prot., datë 2.8.2023, ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit, në zbatim të përcaktimeve të aneksit A të rregullores.

- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “Nova Solar System” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin sipas përcaktimeve të nenit 9, për pikën 1.1, germat: “a”, “b”, “c”; për pikën 1.2, germat: “a”, “b”, “c”, “d”; për pikën 1.3, germat: “a”, “b”, “c”; për pikën 2.1, germat: “a”, “b”, “d”, “e”, “f”.

- Për sa i përket miratimit të pikës së lidhjes me rrjetin e transmetimit, shoqëria ka depozituar në ERE miratimin në parim dhe ka bërë me dije se është në pritje të lidhjes së aktmarrëveshjes përfundimtare të pikës së lidhjes. Në këto rrethana, vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë që të depozitojë në ERE aktmarrëveshjen me OST-në,



për miratimin e pikës së lidhjes përpara fillimit të operimit.

- Për sa parashikuar në VNM-në paraprake, në lidhje me zbatimin në terren të projektit, vlerësohet që t'i lihet kusht shoqërisë të informojë ERE-n, çdo 3 (tre) muaj, në lidhje me fillimin e punimeve të ndërtimit të centralit fotovoltai, por jo më vonë se data 21.10.2024 (datë në të cilën përfundon dhe vlefshmëria e lejes aktuale).

- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Në rastin konkret shoqëria ka plotësuar në formatin përkatës afatin e pritshmërisë së jetëgjatësisë së centralit 35–40 vjet, por ERE kushtëzohet nga parashikimet ligjore në përcaktimin e afatit të vlefshmërisë së licencës, pra për 30 vjet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Nova Solar System” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 50 mw, për një afat 30-vjeçar, me kusht që para fillimit të operimit të depozitohet në ERE aktmarrëveshjen me “Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., për miratimin përfundimtar të pikës së lidhjes.

2. Shoqëria të informojë ERE-n, çdo 3 (tre) muaj, në lidhje me fillimin e punimeve të ndërtimit të centralit fotovoltai, por jo më vonë se data 21.10.2024.

3. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të depozitimit të aktmarrëveshjes me OST sh.a. dhe informacionit në kuadër të vlefshmërisë së VNM-së paraprake.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “Nova Solar System” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “Operatorin e Sistemit të Transmetimit” (OST) sh.a., dhe “Furnizuesin e Tregut të Lirë” sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTAR I BORDIT
Erjola Sadushi

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin nr. 12-2023-150 (30), datë 2.2.2023, vendosi shpalljen të vdekur të shtetasit Naxhi Çaç, i datëlindjes 12.5.1963, si dhe shpalljen e datës 1.7.2005 si datë të vdekjes së tij.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 192 lekë